

INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË

FORCIMI I KAPACITETEVE PENITENCIARE
NË ADRESIMIN E RADIKALIZIMIT NË
BURGJE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

DOKUMENT I POLITIKËS

*ADRESIMI I RADIKALIZIMIT DHE
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË
BURGJET NË BALLKANIN PERËNDIMOR*

Forcimi i gjyqësorit

<https://wbregionprisons.coe.int/>

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës



DOKUMENT I POLITIKËS

**ADRESIMI I RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË
BURGJET NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

MARS, 2023

**BASHKAUTORË: CATHERINE CREAMER, NADYA RADKOVSKA, ATILA JUHASZ DHE JULIE
COLEMAN, KONSULENTE TË KËSHILLIT TË EVROPËS**

Versioni në gjuhën angleze

Addressing radicalisation and violent extremism in prisons in the Western Balkans

Ky dokument i politikës u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit.

Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “©Këshilli i Evropës, 2023”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet drejtohen Njësia për Bashkëpunim në Çështjet Policore dhe Institucionet e Privimit të Lirisë.

@ Këshilli i Evropës, mars, 2023. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	4
PARATHËNIE.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
INFORMATA TË PËRGJITHSHME.....	8
STRUKTURA E DOKUMENTIT TË POLITIKËS.....	8
METODOLOGJIA.....	9
BURIMET E INFORMACIONIT.....	9
DIAGRAMI METODOLOGJIK.....	10
Tema 1: Praktikrat e shqyrtimit, vlerësimit të rrezikut dhe nevojave (VRrN) dhe shpërndarjes në burgje.....	12
Pasqyrë analitike e gjetjeve, zhvillimeve dhe praktikës në Ballkanin Perëndimor	12
Praktikat e shpërndarjes.....	13
Sfidat për aplikimin e mjetit të shqyrtimit.....	13
Trajnimit.....	14
REKOMANDIME PËR MJET SHQYRTIMI.....	14
A. Niveli i politikave dhe legjislativit.....	14
B. Niveli i zbatimit.....	15
Sfidat për zbatimin e një mjeti për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave.....	16
Gjykimi i strukturuar profesional.....	16
Shkëmbimi i informacionit.....	16
Kur të përdoret mjeti për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave?.....	17
Databaza e informacionit.....	17
Angazhimi i të burgosurve dhe pëlqimi i informuar.....	18
REKOMANDIME PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT DHE NEVOJAVE.....	18
A. Niveli i politikave dhe legjislativit.....	18
B. Niveli i zbatimit.....	19
Tema 2: Rehabilitimi, trajtimi dhe shkëputja nga dhuna e të burgosurve të radikalizuar dhe ekstremistë të dhunshëm.....	22
Pasqyrë analitike e gjetjeve, zhvillimeve dhe praktikës në Ballkanin Perëndimor	22
Sfidat për aplikimin e qasjes individuale të rehabilitimit ndaj VEP.....	22
Kapacitetet rehabilituese në përfituesit.....	23
Kosova*.....	23

* Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Shqipëria	24
Bosnjë e Hercegovina	24
Maqedonia e Veriut	25
Serbia.....	26
REKOMANDIME për rehabilitimin dhe shkëputjen nga dhuna	26
A. Niveli i politikave dhe legjislativit	26
B. Niveli i zbatimit	28
Tema 3: Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i praktikuesve të burgjeve dhe atyre të shërbimit sprovues.....	30
Pasqyrë analitike e gjetjeve, zhvillimeve dhe praktikës në Ballkanin Perëndimor	30
Kapacitetet e trajnimit në burgje dhe shërbimin sprovues në përfituesit.....	30
REKOMANDIME për Ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e stafit të burgjeve dhe shërbimit sprovues	32
A. Niveli i politikave dhe legjislativit	32
B. Niveli i zbatimit	34
Tema 4: Përgatitja për lirim, asistencë pas vuajtjes së dënimit dhe riintegrim në shoqëri.....	36
Pasqyrë analitike e gjetjeve, zhvillimeve dhe praktikës në Ballkanin Perëndimor	36
Nota mesatare për përfituesit – Para-lirimi dhe riintegrimi	36
Komentet e marra nga përgjigjet e përfituesve në pyetësorë	37
Praktikë e mirë	37
Sfidat.....	37
Qëndrueshmëria në të ardhmen	38
Sfidat.....	39
REKOMANDIME për asistencë para lirimit dhe pas vuajtjes së dënimit.....	41
A. Niveli i politikave dhe legjislativit	41
B. Niveli i zbatimit	43
Shtojca 1 – Kurrikula e përbashkët kornizë për trajnimin bazë dhe të avancuar të stafit të burgjeve dhe shërbimit sprovues	45
Shtojca 2 - Lista e kontrollit të para-lirimit	48
Shtojca 3 – Regjimi shembull	49

LISTA E SHKURTESAVE

Bosnjë e Hercegovina	BeH
Këshilli i Evropës	KiE
Organizatat e Shoqërisë Civile	OshC
Luftimi i terrorizmit	LT
Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	KEDNJ
Luftëtar i huaj terrorist	LHT
Edukimi për të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë	HELP
Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Penale	ICITAP
Shërbimi Korrektues i Kosovës	ShKK
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	AKI
Policia e Kosovës	PK
Ekipi shumë-disiplinor	EshD
Ministria e Punëve të Brendshme	MPB
Organizatë jo-qeveritare	OJQ
Ekipi kombëtar operativ	EKO
Sjellje paralele e shkeljes	SPSh
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë	OSBE
Parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm	P/LEDh
Çrregullimi i stresit post-traumatik	PTSD
Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin	RrNR
Vlerësimi i rreziqeve dhe nevojave	VRrN
Procedura standarde të veprimit	PSV
Mjeti i shqyrtimit	MSh
Ekipi për ofrimin e asistencës	EOA
Grupi tematik	GT
Trajnimi i trajnerëve	TiT
I burgosur ekstremist i dhunshëm	VEP
Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm	VERLT
Ballkani Perëndimor	BP
Grupi punues	GP

PARATHËNIE

Të nderuar kolegë dhe partnerë,

Falë jush dhe përkushtimit dhe angazhimit tuaj, ne kemi përfunduar me sukses zbatimin e veprimit rajonal të Instrumentit Horizontal **“Forcimi i kapaciteteve penitenciare në adresimin e radikalizimit në burgje në Ballkanin Perëndimor”**. Më shumë se 90 aktivitete u realizuan me pjesëmarrjen e më shumë se 1,500 praktikuesve nga Ballkani Perëndimor, aktivë në fushën e parandalimit të radikalizimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Ne besojmë fuqimisht se kemi përmbushur qëllimet e vendosura në fillim të veprimit. Rritëm ndjeshëm ndërgjegjësimin dhe njohuritë e publikut profesionist për dukuritë e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe rritjen e kulturës së shkëmbimit të informacionit dhe shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira. Akoma më shumë, njohuritë dhe shkathësitë e praktikuesve që punojnë me të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (VEP) dhe të burgosurit e radikalizuar në baza ditore u forcuan më tej, ndërsa metodologjitë, mjetet dhe qasjet në punën me këtë kategori shkelësish u përmirësuan në përputhje me nevojat e përfituesve.

Në këtë sipërmarrje të përbashkët, kur flitet për menaxhimin dhe rehabilitimin e VEP-ve, së bashku identifikuam anët e forta dhe dobësitë e sistemeve penitenciare dhe të shërbimit sprovues në rajon, të cilat na mundësuan të përcaktojmë përfundime dhe të nxjerrim rekomandime të përbashkëta për të gjithë rajonin dhe specifike për secilin përfitues.

Në këtë drejtim, ky dokument gjithëpërfshirës u ofron vendimmarrësve strategji për zhvillimin e politikave të përshtatura, si dhe rekomandime për zbatimin e tyre së bashku me udhëzime për menaxherët dhe praktikuesit. Ky grup rekomandimesh duhet të merret parasysh në kontekstin e karakteristikave specifike të çdo sistemi penitenciar në rajon dhe faktit që ato ndryshojnë në aspektin e organizimit, strukturës dhe burimeve të disponueshme, duke pasur parasysh gjithashtu se ky fenomen është dinamik dhe i prirur për ndryshime. Nuk ka zgjidhje ‘të vetme’, por është e sigurt që çdo përfitues do të jetë në gjendje të identifikojë rekomandimet dhe udhëzimet që janë reale, të adaptueshme dhe të zbatueshme për sistemin e tyre.

Ne mbetemi të përkushtuar për të siguruar stabilitet afatgjatë të shoqërive tona me respekt të plotë të të drejtave të njeriut dhe do të vazhdojmë të mbështesim politikëbërësit, menaxherët e burgjeve dhe praktikuesit në tejkalimin e sfidave kur trajtojmë radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në burgje dhe ndërkohë që mbështesim të burgosurit e liruar për t’u riintegruar në komunitetet e tyre.

Me respekt,

Tanja Rakusic-Hadzic
Shefe e Njesisë për Bashkëpunim Policor dhe Privim nga Liria
Këshilli i Evropës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dokumenti i politikës në vijim ofron një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore që kanë dalë nga veprimi rajonal i Këshillit të Evropës "Forcimi i kapaciteteve penitenciare në adresimin e radikalizimit në burgje në Ballkanin Perëndimor". Veprimi, i zbatuar në gjashtë përfitues në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosova, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, filloi në vitin 2019 për të forcuar kapacitetet e përfituesve në menaxhimin e VEP-ve dhe parandalimin e radikalizimit në dhunë brenda burgjeve.

Duke ditur se burgjet mund të jenë inkubatorë për ideologjinë e ekstremistëve të dhunshëm, por gjithashtu mund të jenë institucione për reforma, një numër i autoriteteve të burgjeve në Evropë kanë krijuar programe të specializuara rehabilitimi të bazuara në burgje për ekstremistët e dhunshëm, të cilat kanë qëllimin përfundimtar t'u mundësojnë këtyre individëve të riintegrohen me sukses në shoqëri pas lirit të tyre. Ekzistojnë një sërë sfidash në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të tilla në të gjithë Evropën. Disa nga këto sfida kanë të bëjnë me efektivitetin e programeve të bazuara në burg, të dizajnuara për rehabilitimin e VEP-ve me qëllim zbutjen e rrezikut të mundshëm dhe vlerësimin e pamjaftueshëm të ndikimit të tyre. Në përshtatjen e programeve të rehabilitimit për VEP, formulimi i objektivave afatshkurtra dhe afatgjata të arritshme dhe të matshme, si dhe treguesve, është thelbësor për monitorimin e progresit dhe efektivitetit. Kur kemi të bëjmë me VEP në burgje, miratimi i një qasje individuale është kyç në drejtim të zbatimit të ndërhyrjeve rehabilituese. Është e rëndësishme të kuptohet historia personale, motivimi, perceptimet, shqetësimet, zhgënjimi, pikat e forta dhe mangësitë e çdo VEP. Përveç faktorëve të brendshëm, në ofrimin e mbështetjes efektive duhet të merren parasysh edhe faktorët e jashtëm si mjedisi social individual dhe rrethana të tjera lokale.

Prandaj, një vlerësim individual i rrezikut dhe nevojave (VRrN) është i nevojshëm për të identifikuar një ndërhyrje rehabilituese të përshtatur. Mjetet e VRrN-së nuk synojnë të jenë parashikuese dhe kërkojnë trajnim të mjaftueshëm dhe të vazhdueshëm të stafit që do të jetë përgjegjës për kryerjen e vlerësimeve. Mjetet e shqyrtimit dhe VRrN-ja mund të luajnë rol jetik në sigurimin e informacionit të rëndësishëm në një mënyrë të strukturuar që mund të përdoret për të planifikuar dhe zbatuar plane gjithëpërfshirëse për çdo VEP. Ky ishte fokusi i Grupit tematik (GT) 1: Shqyrtimi, vlerësimi i rrezikut dhe nevojave.

Ndërhyrjet rehabilituese të dizajnuara për të adresuar sjelljen kognitive të VEP-ve, duke përfshirë adresimin e tendencës së tyre për të menduar bardhë e zi, dhe rreziqe dhe nevoja të tjera janë kritike për t'i mundësuar individit të riintegrohet përfundimisht në shoqëri dhe të sillet në mënyrë prosociale. Në lidhje me ndërhyrjet specifike të VEP-ve, rekomandohet përfshirja e aktiviteteve më të përgjithshme të burgjeve për të mbështetur dhe përforcuar procesin e ndryshimit (trajnim profesional, aktivitete edukative, aktivitete kulturore, ndërhyrje psikosociale). Megjithatë, disa ndërhyrje dhe aktivitete mund të jenë kundërproduktive për individë të caktuar dhe rreziqet që lidhen me pjesëmarrjen e tyre duhet të vlerësohen dhe monitorohen me kujdes. Duhet të krijohet një qasje shumë-disiplinore për të siguruar që kompleksiteti i çështjeve që qëndrojnë në themel të ekstremizmit të dhunshëm mund të adresohet siç duhet nga një sërë aktorësh me kompetenca dhe ekspertizë plotësuese. Ndërhyrjet rehabilituese duhet të hartohen, zhvillohen dhe zbatohen duke marrë parasysh kushtet lokale, legjisllacionin, popullsinë e burgjeve dhe stafin në dispozicion.

Në këtë kontekst, një nga objektivat kryesore të veprimit rajonal është të kontribuojë në rehabilitimin dhe shkëputjen nga dhuna duke vlerësuar nevojat, zhvillimin e programeve rehabilituese për VEP dhe trajnimin e stafit. Ky ishte fokusi i GT 2: Rehabilitimi dhe shkëputja nga dhuna.

Për të kryer vlerësime të sakta dhe për të zbatuar ndërhyrje efektive rehabilituese, është jetike që personeli i burgjeve dhe i shërbimit sprovuës të jetë sistematikisht i mirëtrajnuar.

Trajnimi brenda përfituesve mbetet kryesisht ad hoc, gjë që mund të ndikojë negativisht në besimin dhe kompetencën e stafit për të menaxhuar VEP-të përgjatë vazhdimësisë së daljes nga burgju. Trajnimi bazë dhe rritja e ndërgjegjësimit, trajnimi i specializuar dhe zbatimi i parimeve dinamike të sigurisë kontribuojnë në rezultate të suksesshme, por do të kërkojnë angazhimin e burimeve financiare të qëndrueshme me kalimin e kohës.

Nevoja për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e praktikuesve të burgjeve dhe të shërbimit sprovues ishte fokusi i GT 3. Ndërkohë që ndërhyrjet që bëhen brenda burgut për VEP-të janë padyshim integrale për adresimin e sfidës së VEP-ve, është po aq e domosdoshme që të bëhen përgatitje gjithëpërfshirëse për fazën pas vuajtjes së dënimit gjatë së cilës VEP-të do të kthehen në komunitetet e tyre. Kjo përfshin zhvillimin e ekipeve shumë-disiplinore (ESHd) të cilët mund të mbështesin zbatimin e strategjive të daljes për çdo individ. Ndërhyrjet rehabilituese duhet të vazhdojnë edhe në nivel komuniteti. Kjo mund të përfshijë sigurimin që mbështetja e vazhdueshme psikosociale të vihet në dispozicion të VEP-ve të liruar, së bashku me mbështetjen për aspekte të tilla si strehimi, kujdesi shëndetësor dhe arsimiti.

Zhvillimi i PSV-ve për fazën pas vuajtjes së dënimit për të siguruar që aktorët e ndryshëm të përfshirë pas lirimit të veprojnë në koordinim është një hap i rëndësishëm për përfituesit. GT 4 u fokusua në: përgatitjen për lirim, ndihmën pas vuajtjes së dënimit dhe riintegrimin. Për të adresuar sfidat në këto katër tema, veprimi rajonal siguroi një forum për praktikuesit dhe politikëbërësit për t'u takuar dhe shkëmbyer informacion, njohuri, praktika më të mira dhe përvoja. Ky dokument politike mbledh sfidat dhe praktikat e identifikuara gjatë një sërë aktivitetesh dhe grupesh punuese, në mënyrë që të identifikojë udhëzimet për politikën e ardhshme për të siguruar që qasja për adresimin e radikalizimit në burgjet e përfituesve të vazhdojë të bazohet në politika të bazuara në prova dhe të bazohet mbi metodat efektive që do të mbështesin riintegrimin e suksesshëm të VEP-ve dhe do të reduktojnë rrezikun për komunitetet pas lirimit.

INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Në tetor 2019, Këshilli i Evropës (KiE) nisi veprimin rajonal "Rritja e kapaciteteve penitenciare në adresimin e radikalizimit në burgjet në Ballkanin Perëndimor" në kuadër të Programit të Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 (tani e tutje veprimi). Programi u bashkëfinancua nga Bashkimi Evropian dhe KiE-ja dhe është zbatuar nga KiE-ja. Veprimi i parapriu Konferenca Rajonale e mbajtur në Shkup më 03-04 tetor 2018 që ofroi një forum për autoritetet e burgjeve dhe praktikuesit nga të gjashtë përfituesit e Instrumentit Horizontal nga Ballkani Perëndimor (BP) në të cilën u diskutuan sfidat e parandalimit dhe adresimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgje. Pjesëmarrësit mirëpritën fuqimisht rritjen e bashkëpunimit rajonal, shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira për qasjet dhe metodologjitë për të trajtuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin në burgje dhe kërkuan forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve të tyre përkatëse të burgjeve. U identifikuan katër fusha kryesore tematike:

- shqyrtimi, vlerësimi i rrezikut dhe nevojave dhe praktikave të shpërndarjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm (VERLT);
- rehabilitimi dhe shkëputja nga dhuna;
- ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i praktikuesve të burgjeve dhe të shërbimit sprovues për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit; dhe
- përgatitja për lirim, ndihma pas vuajtjes së dënimit, riintegrimi i të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (VEP).

Qëllimi i përgjithshëm i aktivitetit të projektit ishte të kontribuonte në sigurinë rajonale duke trajtuar radikalizimin në burgje dhe duke shkëputur nga dhuna të burgosurit ekstremistë të dhunshëm.

¹Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia.

Përfituesit kryesorë ishin ministrinë përkatëse të drejtësisë – departamentet penitenciare dhe të shërbimit sprovues, ndërsa për mbështetje të partnerëve morën rolin organet koordinuese të parandalimit dhe koordinimit të ekstremizmit të dhunshëm (P/LEDh), ministrinë e punës dhe politikave sociale, ministrinë e punëve të brendshme dhe organizatat e shoqërisë civile.

Qëllimet specifike të veprimit ishin: të rrisin ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e procesit të radikalizimit në burgje, të inkurajojnë një kulturë të shkëmbimit të informacionit dhe praktikave të mira për të siguruar komunikim të rregullt dhe shkëmbim të njohurive dhe praktikave më të mira me grupe të tjera profesionale (si p.sh. Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin (RrNR), të ndihmojnë praktikuesit në njohjen e shenjave të radikalizimit dhe fuqizimin e zyrtarëve të linjës së parë me njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme, si dhe lehtësojnë dhe inkurajojnë partneritetin e shumë agjencive.

Për të përmbushur këto synime, u krijuan katër grupe rajonale tematike që u mundësuan praktikuesve dhe politikëbërësve të takohen dhe të shkëmbejnë informacionin, njohuritë, praktikat më të mira dhe përvojat në punën me VEP – duke u përballur me sfida të ngjashme ose specifike në të gjithë rajonin në parandalimin dhe luftën kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në një kontekst burgju dhe pas lirit. Gjithashtu, u zbatuan një sërë aktivitete të tjera si vizita rajonale në terren, trajnime në internet. Përveç aktiviteteve rajonale, një numër i aktiviteteve u hartuan në mënyrë specifike dhe plotësuan nevojat prioritare të **Serbisë, Shqipërisë** dhe **Kosovës** në kuadër të komponentëve specifike të përfituesit të veprimit të hartuar për këta tre përfitues. Për më tepër, veprimi koordinoi ngushtë aktivitetet e tij të dimensionit rajonal me qasjet specifike të përfituesit për **Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut** dhe **Bosnje-Hercegovinën**, të cilat u zhvilluan nën kujdesin e projekteve të tjera specifike për vendin.

STRUKTURA E DOKUMENTIT TË POLITIKËS

Ky dokument politikë është një përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve për përfituesit e Ballkanit Perëndimor bazuar në 12 dokumente diskutimi që pasuan pas çdo takimi të grupeve tematike rajonale, 32 forume koordinuese lokale dhe diskutime mbi mbështetjen e pas-lirit dhe riintegrit të ish-VEP-ve, që përfshinte më shumë se 670 aktorë në shoqëri nga niveli qendror në atë lokal, komunikim të drejtpërdrejtë dhe komente nga praktikuesit e burgjeve dhe të shërbimit sprovues që morën pjesë në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve specifike për përfituesit dhe aktivitetet pilotuese dhe 26 konkluzione dhe rekomandime nga dy konferencat përfundimtare rajonale. Udhëzimet për politikën e ardhshme bëhen në dy nivele, përkatësisht, legjislativ (që synojnë autoritetet legjislativ, politikëbërësit dhe vendimmarrësit) dhe implementues (që synojnë menaxhmentin e mesëm dhe të ulët, praktikuesit dhe linjat e para).

Si rezultat, u formuluan një udhëzim dhe politika të qëndrueshme të bazuara në prova. Për këtë qëllim, ndërsa ka disa udhëzime specifike për përfituesit, shumica e udhëzimeve janë më të zbatueshme dhe të përbashkëta për të gjithë përfituesit.

²Konferenca rajonale “Drejt përmirësimit të praktikave në parandalimin e radikalizimit dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe trajnimin e stafit në Ballkanin Perëndimor” e mbajtur më 17–18 maj 2022 në Budva, Mali i Zi dhe Konferenca Rajonale “Drejt menaxhimit të suksesshëm, rehabilitimit dhe asistencës pas vuajtjes së dënimit për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (VEP) në Ballkanin Perëndimor – arritjet dhe rruga përpara” e mbajtur më 04 – 05 tetor 2022 në Tiranë, Shqipëri.

METODOLOGJIA ALBANS

Fokusi i grupeve tematike rajonale si pjesë e këtij projekti ishte të shikonin më në thellësi praktikën më të mira dhe sfidat e përbashkëta në të gjithë rajonin në lidhje me parandalimin e radikalizimit dhe menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje. Për këtë qëllim, dokumentet përfundimtare të diskutimit nga çdo takim shqyrtonin praktikën e përbashkëta në rajon dhe zhvillimin e një inventari të qasjeve që zbatohen aktualisht në rajon, dhe theksuan fushat për zhvillim të mëtejshëm së bashku me kërkesat për mbështetje për përfituesit. Si rrjedhim, qasja metodologjike ndaj këtij dokumenti ishte të 'kapte' në mënyrë tematike rezultatet e këtyre shumë dokumenteve të diskutimit (12) për të formuluar udhëzime mbi politikën dhe procedurat për të ecur përpara.

Ky dokument përdor një qasje cilësore që përfshin një shqyrtim tematik të rezultateve, dokumentet përfundimtare të diskutimit, konkluzionet e dy konferencave përfundimtare rajonale, raportet e vlerësimit të dorëzuara nga përfituesit e granteve në rajon në forumet lokale të koordinimit dhe raportet e vlerësimit për pilotimin e mjeteve/programeve specifike për VEP në *Serbi, Kosovë* dhe *Shqipëri*. Për më tepër, duke pasur parasysh se disa nga dokumentet e diskutimit datojnë në vitin 2019, për të ofruar një vështrim më bashkëkohor të praktikës aktuale në të gjithë rajonin e BP-së, pyetësorët iu dërguan të gjashtë përfituesve për të ofruar një përditësim të statusit të tyre aktual në lidhje me zbatimin e plotë të aspekteve të ndryshme të projektit dhe rekomandimet e tyre për politikën dhe planifikimin e ardhshëm. Për këtë qëllim, ky raport kërkon të sigurojë që të gjithë zërat të jenë 'dëgjuar' dhe të sigurojë bazën e provave për politikën, legjislacionin dhe vendimmarrjen e ardhshme.

BURIMET E INFORMACIONIT

Informacioni që përmban ky raport rezulton nga të dhënat parësore (pyetësorët) dhe të dhënat dytësore të brendshme dhe të jashtme (dokumentet e diskutimit, raportet e përfituesve-grantëmarrësve, dokumentet e vlerësimit pilot dhe gjetjet e konferencave rajonale). Shtojca 1 përmban një listë të dokumenteve të përdorura për këtë raport.

Më poshtë janë renditur ngjarjet rajonale të zbatuara në kuadër të Veprimit që shërbyen si gur themeli për analizën dhe rekomandimet gjithëpërfshirëse të këtij Dokumenti Politike.

- ✓ Tema 1 e GP-së së 1-rë më 15-16 tetor 2019 Hotel CenterVille, Podgoricë
- ✓ Tema 1 e GP-së së 2-të më 11-12 shkurt 2020 Hotel CenterVille, Podgoricë
- ✓ Tema 1 e GP-së së 3-të më 1-3 dhjetor 2020 në internet
- ✓ Tema 2 e GP-së së 1-rë më 13-14 nëntor 2019 Hotel Novotel Bristol, Sarajevë
- ✓ Tema 2 e GP-së së 2-të më 9-10 qershor 2020 përmes platformës Kudo në internet
- ✓ Tema 2 e GP-së së 3-të më 13 dhe 14 tetor 2021 Hotel Ibis Styles, Sarajevë
- ✓ Tema 3 e GP-së së 1-rë më 11-12 dhjetor 2019 Hotel Rogner, Tiranë
- ✓ Tema 3 e GP-së së 2-të më 6-7 korrik 2020 përmes platformës Kudo në internet
- ✓ Tema 3 e GP-së së 3-të më 17-18 nëntor 2021 Hotel MAK, Tiranë

³Serbia nuk i ka ofruar ekipit të projektit përgjigje të përditësuara për pyetësorët

- ✓ Tema 4 e GP-së së 1-rë më 21-22 janar 2020 në Hotel Holiday Inn, Shkup
- ✓ Tema 4 e GP-së së 2-të më 4-6 nëntor 2020 përmes platformës në internet
- ✓ Tema 4 e GP-së së 3-të më 21-22 dhjetor 2021 në Hotel Marriott, Shkup
- ✓ Konferencë rajonale: "Drejt përmirësimit të praktikave në parandalimin e radikalizimit dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe trajnimin e stafit në Ballkanin Perëndimor", më 17-18 maj 2022 në Hotel Splendid, Budva (Temat 1 dhe 3)
- ✓ Konferenca e fundit rajonale: "Drejt menaxhimit të suksesshëm, rehabilitimit dhe ndihmës pas vuajtjes së dënimit për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (VEP) në Ballkanin Perëndimor – arritjet dhe rruga përpara", më 04-05 tetor 2022 në Hotel MAK, Tiranë (Temat 2 dhe 4).

DIAGRAMI METODOLOGJIK

**Analiza e dokumenteve
diskutimi të grupit
tematik**

**Analiza e raporteve të
përfituesve të grantit
dhe konkluzioneve të
konferencave rajonale**

Pyetësorë për përfituesit

**Literatura përkatëse
empirike dhe udhëzimet
e praktikave më të mira
ndërkombëtare**

**Gjetjet e integruara dhe rekomandimet e formuluarat të
politikave!**

TEMA

1

Praktikat e shqyrtimit, vlerësimit të rrezikut dhe nevojave (VRrN) dhe shpërndarjes në burgje



Pasqyrë analitike e gjetjeve, zhvillimeve dhe praktikës në Ballkanin Perëndimor

Në fillim të projektit, me përjashtim të *Bosnjë dhe Hercegovinës (BeH)* dhe *Maqedonisë së Veriut* të cilët kishin zhvilluar një mjet VRrN (të rishikuar më vonë), asnjë përfitues nuk kishte mjete specifike të shqyrtimit ose VRrN-së për VEP. Shumë prej tyre kishin marrë disa trajnime ndërgjegjësimi mbi radikalizimin, por nuk kishin udhëzime specifike për të informuar gjykimin profesional në këtë fushë. Në fund të projektit, shumica e përfituesve kanë zhvilluar dhe pilotuar si një mjet shqyrtimi dhe rreziku/nevojash në juridiksionet e tyre, me disa në fazën e zbatimit të plotë të të dyja mjeteve. Përjashtim nga kjo bën *Mali i Zi*, të cilët kanë zhvilluar një mjet të VRrN-së, por që kanë një numër shumë të vogël të VEP-ve dhe për këtë arsye kanë përcaktuar se ka mungesë nevojë në këtë fushë. Në të gjithë përfituesit e tjerë si mjetet e shqyrtimit ashtu edhe ato të VRrN-së janë në përdorim, por në nivele të ndryshme. Një seri pyetësorësh iu dërguan përfituesve për të ofruar një 'fotograf' se ku ndodhen aktualisht me zbatimin e mjetit të shqyrtimit dhe VRrN-së.

Pesë nga gjashtë përfituesit u përgjigjën dhe siç shihet në Tabelën 1, niveli i kënaqësisë dhe zbatimi i mjeteve varionte nga shkëlqyeshëm deri në neutral. Komentet nga përfituesit shpjegojnë këto pikë numerike në më shumë detaje. Gjetja e parë është ndoshta më informuese në atë që mjeti i shqyrtimit zbatohet sipas nevojave të të burgosurve dhe jo një mjet i përgjithshëm shqyrtimi. Me fjalë të tjera, mjeti zbatohet për ata që konsiderohet i nevojshëm, në vend të qëllimit të synuar, për të kontrolluar atë që nuk është e dukshme. Kjo ka qenë një sfidë e zakonshme për të gjithë përfituesit në atë që ata aplikojnë mjetin e shqyrtimit vetëm për ata që janë dënuar për terrorizëm.

Tabela 1. Shqyrtimi dhe VRrN - Nota mesatare ndërmjet përfituesve

Shqyrtimi	Shkëlqyeshëm	Mirë	Neutral	Dobët
Kënaqshëm	2	3		
Niveli i zbatimit	1	2	1	1
VRrN	Shkëlqyeshëm	Mirë	Neutral	Dobët
Kënaqshëm	1	2	2	
Niveli i zbatimit		2	1	2
Transferimi i njohurive në praktikë	1	4		
Pronësia		2	3	
Dobia e trajnimit	2	3		

⁴Pilotimi i mjeteve/programave specifike për VEP u përfundua me sukses në Serbi dhe Kosovë gjatë vitit 2021 dhe në Shqipëri në vitin 2022.

Bazuar në komentet në pyetësorë të dorëzuar nga përfituesit në lidhje me përdorimin e mjetit të shqyrtimit dhe VRrN-së, mund të nxirren përfundimet në vijim: aplikimi i mjetit të shqyrtimit është i rrallë për shkak të numrit të vogël të të burgosurve të dënuar për terrorizëm dhe po zbatohet sipas nevojave të të burgosurve, d.m.th., atyre të dënuar për terrorizëm. Megjithatë, të gjithë përfituesit e kuptojnë rëndësinë e aplikimit të mjetit të shqyrtimit si mjet bazë për identifikimin e të dënuarve që kanë ide radikale, veçanërisht në fillim të dënimit. Sipas ligjeve dhe akteve nënligjore, juridiksione të caktuara janë të detyruara të përdorin mjetin e shqyrtimit, megjithatë ai përdoret kryesisht për të burgosurit e dënuar për akte kriminale të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Për sa i përket aplikimit të VRrN-së, përfituesit e konsiderojnë atë të nevojshëm dhe të domosdoshëm, megjithatë përvojat e pilotimit dëshmuuan se ai është mjet kompleks, dhe disa treguan se duhet ende trajnimi i stafit të burgjeve për ta shfrytëzuar atë.

Aktualisht, si mjetet e shqyrtimit ashtu edhe të VRrN-së janë mjete që aplikohen vetëm në ato institucione ku kjo kategori e të dënuarve vuan dënimin me burg dhe ku ekziston baza ligjore për aplikimin e tij (mjeti i shqyrtimit dhe i vlerësimit të rrezikut dhe nevojave). Kjo ka bërë që në disa përfitues të planifikohet një modul i posaçëm trajnimi për aplikimin e mjetit të VRrN-së. Në përgjithësi, stafi psikosocial plotëson formularin e VRrN-së dhe përfituesit e konsiderojnë të përshtatshme formularin e përdorur për të kryer VRrN-ën.

Megjithatë, shkëmbimi i informacionit ndërmjet agjencive të ndryshme është i dobët dhe shumica kanë shprehur nevojën për të pasur më shumë informacion nga struktura si Policia e Shtetit, Qendra LEDh, Prokuroria. Edhe pse stafi i burgjeve ka kryer trajnime dhe trajnime kaskadë mbi temën e zbatimit praktik të mjetit të shqyrtimit (MSh) dhe vlerësimit të rrezikut dhe nevojave (VRrN), u theksua se nevojiten trajnime shtesë në këtë fushë për personelin e burgut, i cili do të duhet të zbatojë plotësisht mjetin dhe instrumentin bazë për vlerësimin e rrezikut në të ardhmen.

Praktikat e shpërndarjes

Praktika e caktimit priret të standardizohet në të gjithë rajonin e BP-së në atë që në shumicën e rasteve gjykata vendos për caktimin dhe kategorizimin e një të burgosuri. Si të tillë, të dënuarit për një vepër terrorizmi, ose për një vepër të lidhur me terrorizmin, strehohen në një burg me një njësi të caktuar për VEP. Megjithatë, ka disa raste të shpërndarjes, si p.sh në *Maqedoninë e Veriut* dhe në *Shqipëri*. Në *BeH* ka pasur një zhvendosje në praktikë nga strehimi i VEP-ve në mënyrë të decentralizuar në qendrën e paraburgimit të tipit të mbyllur në burgun e Zenicës në Burgun Shtetëror të *BeH-së*, ku parimi i caktimit është i centralizuar.

Ndërkombëtarisht, ka debat për shpërndarjen më të përshtatshme të të burgosurve që janë dënuar për një vepër terrorizmi, me argumente për shpërndarje që rezultojnë nga nevoja për t'i ekspozuar VEP-të ndaj 'normave' të të burgosurve të tjerë dhe mënyrave të ndryshme të të menduarit, dhe për të kufizuar kontrollin që VEP-të me ndikim mund të kenë mbi të tjerët brenda grupit. Argumentet për strehim të veçantë përfshijnë qëllimin e frenimit të ideologjive ekstremiste të të burgosurve të tillë nga infiltrimi i të burgosurve të tjerë. Në rastin e *Maqedonisë së Veriut*, siç u përmend më parë, shpërndarja rezultoi në radikalizimin e të burgosurve të tjerë jo-VEP. Gjatë gjithë diskutimeve mes praktikuesve në takimet rajonale, pati një konsensus se në disa raste të burgosurit e tjerë mund të mos i kuptojnë praktikën e ndryshme të të burgosurve VEP, të cilat mund të çojnë në konflikt. Pavarësisht çështjes së ndarjes së VEP-ve të dënuar, do të ketë ende të burgosur që janë dënuar për vepra jo-terroriste, por që megjithatë kanë qëndrime ekstremiste, duke vënë në dukje nevojën e shqyrtimit të përgjithshëm të përfituesit me nivele të larta të ekstremizmit në komunitet.

Sfidat për aplikimin e mjetit të shqyrtimit

Për sa i përket ndarjes së VEP-ve, për shkak se gjykata vendos për ndarjen dhe kategorizimin e të burgosurve, siç u përmend më lart, aktualisht ka pak vend për zgjedhje se ku strehohen të burgosurit. VEP-të mbahen në akomodim të veçantë krahas popullatës së përgjithshme, me shumicën e përfituesve që bien dakord se për disa arsye kjo ishte preferenca e tyre. Për këtë arsye, disa përfitues vendosën të mos aplikonin mjetin e shqyrtimit duke qenë se VEP-të mbaheshin larg popullatës së përgjithshme të burgjeve dhe për këtë arsye nuk mund të 'ndotnin' popullatën e përgjithshme të burgjeve. Megjithatë, një çështje në *Maqedoninë e Veriut* që përfshinë radikalizimin e të burgosurve ndoshta shërben për të nxjerrë në pah nevojën për përdorimin e mjetit të shqyrtimit në të gjithë popullsinë e burgjeve, veçanërisht në mesin e përfituesve ku ka një incidencë të lartë të radikalizimit në komunitetin e përgjithshëm.

Në këtë rast të veçantë, mjeti i shqyrtimit nuk u përdor në të gjithë popullatën e përgjithshme të burgjeve, dhe për këtë arsye nuk dihej që një numër i të burgosurve jo-VEP ishin në rrezik të radikalizimit të burgosurit e tjerë. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, ngjashëm me përfituesit e tjerë, *Maqedonia e Veriut* ende e aplikon mjetin vetëm në ato institucione ku VEP janë duke vuajtur dënimin me burg. Asnjë përfitues nuk e aplikon mjetin për të paraburgosurit ose për popullatën e përgjithshme të burgjeve në përgjithësi. Megjithatë, ideja e mjetit të shqyrtimit është të zbulojë atë që nuk është e dukshme. Për këtë qëllim, është e qartë se një individ i dënuar për terrorizëm ndoshta në rrezik të radikalizojë të tjerët, megjithëse ky nuk është aspak një përfundim i paramenduar.

Ajo që nuk është aq e dukshme është se një anëtar i popullsisë së përgjithshme të burgjeve, i cili mund të dënohet ose në paraburgim për një krim krejtësisht të pandërlidhur, mund të rrezikojë të radikalizojë të tjerët. Siç vërehet nga Silke (2014), terroristët janë heterogjenë dhe kundërshtojnë kategorizimin e thjeshtë në një lloj ose profil, që do të thotë se nuk janë gjithmonë të lehtë për t'u dalluar, veçanërisht për të patrajnuarit ose ata me pak përvojë në terrorizëm. Disa që janë të radikalizuar nuk janë të lehtë për t'u dalluar edhe nga profesionistët më të trajnuar. Nuk është se përfituesit ishin të pakënaqur me mjetin e shqyrtimit, përkundrazi siç shihet në tabelën e mësipërme, shumica raportuan se ishin shumë të kënaqur. Problemi duket se është se ai kërkon trajnim dhe kohë, të cilat janë burime të pakta.

Duke thënë se, ata përfitues që kanë zbatuar mjetin e shqyrtimit kanë raportuar se ai nuk kërkon kohë të konsiderueshme pasi vlerësohet në treguesit e sjelljes dhe mund të vlerësohet (në mënyrë ideale) nga stafi i burgut që punon me shkelësit çdo ditë. Përveç kësaj, mjeti i shqyrtimit është krijuar për të kursyer kohë dhe burimet duke mos kryer një vlerësim të plotë të rrezikut/ nevojave për ata që nuk e kërkojnë një gjë të tillë.

Trajnimi

Është e qartë se ekziston një nevojë e vazhdueshme për një qasje më të synuar për trajnimin e stafit mbi shenjat e radikalizimit, e cila do të shërbejë për të ndërtuar besimin e tyre në përdorimin e mjetit të shqyrtimit. Ky trajnim duhet të jetë një proces dinamik nëse dëshiron të japë rezultate. Këtë e dëshmon edhe fakti se që nga fillimi i takimeve rajonale, me mbështetjen e KiE-së, aplikimi i mjetit të shqyrtimit dhe mjetit të VRRN-së ka rritur shkathtësitë dhe besimin e stafit për të qenë në gjendje të identifikojnë disa tregues të sjelljes të dukshme në procesin e radikalizimit, por ka një dakordim në të gjithë rajonin se rruga është ende e gjatë për ta bërë stafin të kualifikuar.

⁵Silke, A. (2014). "Vlerësimi i rrezikut të të burgosurve terroristë dhe ekstremistë", në A. Silke (ed.), *Burgjet, Terrorizmi dhe Ekstremizmi: Çështje Kritike në Menaxhimin, Radikalizimin dhe Reformën*, fq.108-121. Londër: Routledge.

REKOMANDIME PËR MJET SHQYRTIMI

A. Niveli i politikave dhe legjislativit

Ndërkohë që shumë përfitues kanë marrë përsipër dhe kanë zbatuar mjetin, është e qartë nga gjetjet e integruara se për disa përfitues niveli i zbatimit dhe i pronësisë mbeten neutrale deri në dobët. Për këtë qëllim, është e rëndësishme për ata përfitues që nuk e kanë zbatuar mjetin e shqyrtimit dhe as nuk kanë marrë përsipër të pyesin veten se çfarë masash shtesë kërkohen për ta arritur këtë. Aplikimi i mjetit të shqyrtimit përbën fazën e parë në luftën kundër ekstremizmit dhe pothuajse mund të konsiderohet si **'përgjigje e parë'**. Mjeti i shqyrtimit duhet të zbatohet për popullatën e përgjithshme të burgjeve (përfshirë ata në paraburgim), pavarësisht nga caktimi i të burgosurve, veçanërisht në mesin e popullsisë së përgjithshme të burgjeve në ata përfitues që kanë një incidencë të lartë të radikalizimit në komunitet. Ashtu si trajnimi i ndërgjegjësimit për vetëvrasjen dhe vetëdëmtimin që përfshihet në trajnimin fillestar të stafit në shumë përfitues, kjo do të kërkojë qartë trajnime të vazhdueshme për stafin e burgjeve, i cili në mënyrë ideale duhet të përfshihet në çdo **trajnim fillestar** për personelin e burgjeve, përfshirë ata që punojnë në paraburgim.

Ekzaminimi ka implikime të rëndësishme të drejtave të njeriut, por është e rëndësishme që të kemi në krye të çdo politike drejt shqyrtimit, që ne të kërkojmë forma ekstreme të sjelljes. Për shembull, cila është një formë ekstreme e praktikës fetare? Vlerësuesit individualë do të kenë nivele të ndryshme tolerance për këtë dhe shënimet udhëzuese në mjetin e shqyrtimit janë aty për të ulur këtë nivel të subjektivitetit sa më shumë të jetë e mundur. Sa i përket radikalizimit, njohja e sjelljes devijuese shpesh kryhet me një fokus të njëanshëm në normat dhe vlerat personale dhe jo në gjykime të strukturuar për rrugët drejt sjelljes së rrezikshme. Mjeti i shqyrtimit, kur përdoret si duhet, minimizon sistemet individuale të vlerave që mund të ndikojnë në normën për zbulimin e hershëm nëpërmjet një grupi treguesish të qartë. Përfituesit duhet të mbështeten për të kuptuar ekuilibrin e kërkuar midis të drejtave dhe lirive të individëve me shqetësimet për sigurinë publike. Individët janë të lirë të kenë pikëpamje ekstreme dhe madje radikale (Lloyd & Dean, 2015; Smith, 2016), për sa kohë që ata nuk marrin pjesë në dhunë ose nuk e nxisin atë. Politikat në të ardhmen duhet ta balancojnë nevojën për mbrojtje dhe për ta luftuar terrorizmin ndërsa duke zbutur çdo mundësi për të tjetërsuar më tej një individ ose për të luajtur me arsyet e një individi për t'u radikalizuar.

Ndonëse nuk janë bërë rekomandime për sa i përket politikave dhe legjislativitetit të përgjithshëm në lidhje me shpërndarjen e VEP-ve, duhet theksuar se do të ketë të burgosur që janë në mbajtje për vepra që nuk lidhen me terrorizmin, por që megjithatë kanë pikëpamje ekstremiste. Nevoja për ekzaminim në të gjithë popullatën e përgjithshme të burgjeve është e rëndësishme, veçanërisht kur ka nivele të larta të ekstremizmit në komunitet. Nëse një individ ka rezultate të larta në mjetin e shqyrtimit dhe pastaj në VRRn, por nuk dënohet për një vepër terroriste, duhet të ketë legjislativitet dhe politika të qarta në lidhje me vendin ku duhet të vendoset ky i burgosur.

B. Niveli i zbatimit

Nëse zbatimi i përgjithshëm i mjetit të shqyrtimit ndodh në nivele politikash dhe legjislativiteti, është e rëndësishme që i gjithë stafi të trajnohet në bazat se çfarë duhet të kërkojë për sa i përket sjelljes që shqetëson. Siç u përmend më parë, menaxhmenti duhet të sigurojë që për të gjithë punonjësit e rinj në burg, ndërgjegjësimi për radikalizimin të jetë pjesë e trajnimit të tyre fillestar. Mjeti i shqyrtimit mund të plotësohet kurdo që ka sjellje shqetësuese dhe pikat janë aty për të udhëhequr stafin në përcaktimin nëse individit duhet të referohet për një vlerësim më të plotë të rrezikut.

⁶Annemarie van de Weert (2022) Drejtësia dhe vlerësimi i rrezikut: subjektiviteti i shqyrtimit parandalues të proceseve të radikalizimit, *Revistë e Policisë, Inteligjencës dhe Kundër Terrorizmit*, DOI: 10.1080/18335330.2022.2124123

Prandaj nuk kufizohet në pranimet e reja, por në çdo kohë gjatë dënimit të të burgosurit. Është e rëndësishme që rregullat e përgjithshme rreth mjetit të shqyrtimit të respektohen për të kuptuar se i burgosuri nuk ka nevojë të intervistohet si pjesë e shqyrtimit për procesin e radikalizimit. Prandaj, çdo personel sigurie mund të plotësojë mjetin e shqyrtimit nëse i është nënshtruar trajnimit. Kjo do të shërbejë për të kursyer burime të vlefshme për sa i përket ngarkesës me punë të stafit psikosocial. Për më tepër, mjeti i shqyrtimit mund të jetë më i besueshëm nëse plotësohet nga personeli i sigurisë, pasi ata janë me të burgosurin çdo ditë, kështu që ka shumë më tepër gjasa të shohin ndryshime në sjellje.

Ndërsa janë të burgosur, personat e radikalizuar dhe VEP mund të gjejnë disa të rinj dhe të reja të zemëruar, të zhgënjyer që janë në mes të një krize ekzistenciale (Björkman, 2010) dhe në prag për t'u radikalizuar lehtësisht. Një qasje efektive monitoruese është thelbësore për identifikimin e të burgosurve në rrezik për t'u radikalizuar dhe, rrjedhimisht, për parandalimin e tyre nga adoptimi i sjelljeve të dhunshme ekstremiste. Prandaj, monitorimi duhet të fokusohet jo vetëm tek këta individë (d.m.th., tek ata që janë në rrezik), por edhe tek VEP-ët dhe personat e radikalizuar që punojnë si rekrutues, duke përhapur ideologjinë e tyre tek të burgosurit e cenusshëm.

Sa më sipër, lidhur me shpërndarjen, ndonëse nuk janë bërë rekomandime për sa i përket politikave dhe legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me shpërndarjen e VEP-ve, duhet theksuar se do të ketë të burgosur që janë në mbajtje për vepra që nuk lidhen me terrorizmin, por që megjithatë kanë pikëpamje ekstremiste. Në një nivel zbatimi, mjeti i shqyrtimit është jetik në zbulimin e personave të tillë.

Sfidat për zbatimin e një mjeti për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave

U ra dakord nga të gjithë përfituesit, përfaqësuesit e të cilëve morën pjesë në takimet tematike rajonale (2019–2021) që treguesit e sjelljes së radikalizimit dhe jo cenusshmëria ndaj radikalizimit duhet të jenë fokusi i çdo mjeti të VRRN-së, i cili u arrit në secilin përfitues gjatë veprimit. Ngjashëm, strukturimi i një mjeti të VRRN-së për të siguruar zbatueshmërinë e tij në rajonin e Ballkanit Perëndimor u rekomandua dhe u arrit në secilin përfitues gjatë fazës së veprimit nëpërmjet një theksimi në literaturën empirike (faktorë shtytës, tërheqës dhe personalë). Me mbështetjen e KiE-së, një mjet i VRRN-së u zhvillua dhe pilotua me sukses në përfituesit (*Serbi, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Shqipëri*) dhe u zbatua plotësisht në disa nga ta (Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë). Rezultatet e pyetësorëve tregojnë se shumica e përfituesve ishin të kënaqur me mjetin e VRRN-së, dhe ai përdoret sipas mundësive të disponueshme, d.m.th., numri i punonjësve të trajnuar në sektorin e risocializimit. Zbatimi i plotë i një mjeti të VRRN-së ka qenë problematik në disa nivele të ndryshme, megjithatë, me dy përfitues që raportuan se mjeti nuk është zbatuar plotësisht. Ka disa arsye për këtë, kryesorja është se ata përfitues nuk kanë në mbajtje shkelës të cilët janë VEP. Megjithatë, një çështje shtesë është trajnimi dhe besimi në personelin e burgjeve. Ndërsa trajnimi i personelit të burgjeve do të raportohet më plotësisht nën titullin Grupi Tematik në këtë fushë, është e rëndësishme të veçohet trajnimi më i specializuar në VRRN dhe arsyet pse mjeti nuk është zbatuar plotësisht për vendimet e politikave të ardhshme.

Gjykimi i strukturuar profesional

Së pari, deri më tani, në shumicën e përfituesve gjatë kryerjes së vlerësimeve të rrezikut ka pasur një mbështetje dhe pritshmëri kulturore për të marrë një lloj 'note' që do të tregojë nëse një individ është në rrezik të ulët, mesatar ose të lartë. Në dekadën e fundit, megjithatë, ka pasur një zhvendosje nga 'nota' (ose i njohur zakonisht si metoda aktuariale ose e parashikimit të vlerësimit të rrezikut) në një theksim në gjykimin profesional të strukturuar të individualizuar. Në disa nivele të ndryshme, ky ka rezultuar të jetë aspekti më i vështirë për shumicën e përfituesve. Në juridiksione të tjera, personeli psikosocial, në veçanti psikologët dhe mjekët psikiatër, marrin trajnime të gjera dhe të vazhdueshme (shpesh në nivel pasuniversitar dhe më gjerë) në dhënien

e gjykimeve të strukturuar profesionale për sjelljen njerëzore që çojnë në vendime për lirinë ose sanksionet. Trajnimi që përfituesit kanë marrë në vlerësimin e VRrN-së gjatë këtij projekti e ka humbur këtë trajnim të rëndësishëm themelor dhe ka hyrë direkt në vlerësimin më të specializuar të ekstremizmit të dhunshëm. Edhe pse përfituesit janë siguruar se mjeti i VRrN-së nuk ka aftësi parashikuese dhe përdoret për të caktuar individët në formën më të përshtatshme të trajtimit, kjo ka rezultuar në një kufi të konsiderueshëm në nivelet e tyre të besimit. Gjykimi i strukturuar profesional kërkon staf të mirë të burgjeve që mund të përpunojë dhe analizojë rezultatet dhe të dhënat që ata shqyrtojnë dhe një rritje të vazhdueshme të ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të literaturës në lidhje me radikalizimin.

Shkëmbimi i informacionit

Nevoja për përmirësim të vazhdueshëm të shkëmbimit të informacionit ndërsektorial (të brendshëm) dhe shumë-agjencive (të jashtëm) është diskutuar gjatë gjithë projektit dhe mbetet e dukshme sot, me shumë pak ndryshime në atë fushë. Ngritja e një procedure formale do ta lehtësonte këtë proces. Qëllimi i kësaj është të informojë më mirë procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe nevojave në burg dhe të rrisë besimin te stafi se ata po e paracaktajnë vendimmarrjen e tyre në informacion të besueshëm. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme kur të burgosurit nuk pranojnë të intervistohen për qëllime të një vlerësimi të VRrN-së dhe personeli duhet të mbështetet në informacionin e dosjes. Ky informacion i dosjes është shpesh disi i kufizuar duke rezultuar në vendimmarrje të pasigurt në rastin më të keq, por më shpesh, mungesë besimi te stafi ose aftësi për t'i vendosur notë VRrN-së për shkak të mungesës së informacionit. Shënimet udhëzuese që shoqërojnë mjetin e VRrN-së e bëjnë të qartë se nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për një pikë të caktuar, kjo pikë duhet të hiqet. Gjatë fazës së pilotimit, ka pasur disa raste në mesin e përfituesve ku ka pasur kaq shumë pika të lënë pas dore, sa që çdo vendim i bazuar në mjet ishte i pabesueshëm. Gjatë gjithë fazës së zhvillimit dhe pilotimit, u ra dakord vazhdimisht që mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstytucional duhet të bëhen të qëndrueshëm dhe plotësisht të menaxhueshëm nga përfituesit. Një shembull i mirë i këtij procesi është në qasjen (dhe manualin) gjithëpërfshirës të menaxhimit të rastit të zhvilluar në **BeH** ku ka mekanizma të përcaktuar qartë të shkëmbimit të informacionit ndërmjet palëve të ndryshme të interesit. **Kosova** ka një qasje të ngjashme për të pasur një njësi qendrore të inteligjencës dhe person të caktuar për të menaxhuar shkëmbimin e informacionit. Në kryerjen e shqyrtimit formal dhe vlerësimit të rrezikut të të burgosurve në **BeH**, vlerësuesit kanë qasje në të dhënat penale, histori sociale nga qendra për punë sociale, informacion nga shërbimi i sigurisë penitenciare që plotësojnë një pyetësor informacioni (shqyrtimi) kur marrin të burgosurit, informacioni nga raporti miratohet në departamentin e pranimi (psikologu, pedagogu, punëtori social, kriminologu), dhe të dhënat nga shërbimi shëndetësor i burgjeve përfshihen të gjitha në të dhënat për procesin e vlerësimit të rrezikut.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se shkëmbimi i informacionit është një "rrugë e dyanshme". Kjo u duk në diskutimet gjatë takimeve tematike rajonale nga të pranishmit jashtë shërbimit penitenciar, si puna sociale, shërbimet e sigurisë dhe shërbimi sprovues, të cilët kërkojnë informacion mbi rrezikun dhe nevojat kur një individ do të lirohet në komunitet. Për shkak të kërkesave për mbrojtjen e të dhënave dhe klasifikimin, zyrtarëve të burgut dhe të shërbimit sprovues ende u mungon rrjedha e dyanshme e informacionit, në shumë raste ata nuk marrin as informacione shumë elementare si niveli i radikalizimit, bashkëpunëtorët e njohur, përfshirja në mizoritë e luftës, shkathtësitë e veçanta ushtarake etj. Për të shmangur këtë mangësi janë rekomanduar aktivitete të përbashkëta trajnimit për të lehtësuar bashkëpunimin e mëtejshëm, njohuritë dhe zhvillimin e shkathtësive. Në thelb, këto organizata duhet të dinë paraprakisht se çfarë po menaxhojnë dhe si të menaxhojnë rrezikun dhe të plotësojnë nevojat. Informacioni i palëve të treta përfshin raportet e gjykatës, raportet e burgut dhe dokumentacionin tjetër të burgut, raportet e policisë, vlerësimet nga personeli i burgut dhe i shërbimit sprovues, etj.

⁷shih Dokumentin e Diskutimeve, Shqyrtimi dhe VRrN-ja, dhjetor 2020 për një vështrim të zgjeruar të çështjeve rreth sigurisë dinamike.

Ky është zakonisht informacioni më i disponueshëm për procesin e vlerësimit të rrezikut dhe luan rol të madh në informimin e vlerësimit të përgjithshëm.

Kur të përdoret mjeti për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave?

Në çdo fazë të dënimit të një të burgosuri, VRrN-ja është kritike për drejtimin e intervistave dhe planifikimin e dënimit me të burgosurit. Kjo pikë e fundit është e rëndësishme për sa i përket kohës. Shumica e përfituesve kryejnë një vlerësim të VRrN-së gjatë fazës fillestare të pranimit për të burgosurit që janë dënuar për një vepër terrorizmi. Megjithatë, procesi është duke u zhvilluar (ngadalë) ku ata kryejnë një VRrN duke ndjekur rezultatet e mjetit të shqyrtimit. Përveç kësaj, u arrit në përfundimin se VRrN-ja duhet të përsëritet rregullisht për të informuar vazhdimisht planin e dënimit të të burgosurve për të përditësuar çdo rrezik dhe nevojë të pazgjidhur. Kjo ende nuk është zbatuar, por konsiderohet si praktika më e mirë. Së paku, një vlerësim i plotë i VRrN-së duhet të përsëritet përpara lirimit.

Databaza e informacionit

U konkludua vazhdimisht se praktika më e mirë është të kesh një databazë qendrore ku mund të qaset informacioni i të burgosurve për të informuar shqyrtimin dhe vlerësimin e rrezikut. Për më tepër, u rekomandua shumë që informacioni i sigurisë për të informuar vlerësimin e rrezikut të analizohej nga një njësi e inteligjencës së burgjeve. I gjithë personeli që përfundon shqyrtimin e rrezikut duhet të pajiset me një raport të shkurtër sigurie që përshkruan çdo shqetësim sigurie. Në shumë përfitues këto çështje mbeten të pazgjidhura.

Angazhimi i të burgosurve dhe pëlqimi i informuar

Angazhimi i të burgosurve në procesin e intervistës ka qenë një çështje e rëndësishme për të gjithë përfituesit gjatë projektit dhe ndërkohë që shumë punonjës iu nënshtruan trajnimit për intervista motivuese si pjesë e trajnimit fillestar për pilotin, kjo duhej të përsëritej në një numër përfituesish që ndiqnin pilotin. Të dhënat që mbështesin këtë raport sugjerojnë se kjo do të mbetet një kërkesë e vazhdueshme për të gjithë përfituesit që të zhvillojnë kompetenca dhe shkathtësi për të punuar me këtë grup individësh. Megjithatë, vihet re gjithashtu se intervistimi për qëllimin e një vlerësimi të rrezikut është vullnetar për individin (ndërsa kryerja e një vlerësimi të rrezikut nuk është).

REKOMANDIME PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT DHE NEVOJAVE

A. Niveli i politikave dhe legjislativit

Qëllimi i projektit aktual nuk ishte thjesht të mbështeste përfituesit në zhvillimin ose përshtatjen e mjeteve të shqyrtimit dhe VRrN-së, por të sigurohej që këto të zhvillohen nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Çdo udhëzues në zhvillimin e politikave në këtë fushë duhet së pari të sigurojë që ata të mbështesin parime të tilla. E rëndësishme midis tyre është e drejta për lirinë e mendimit (Neni 9 i KEDNj-së), e cila duhet të vazhdojë të ofrojë udhëzime themelore në zhvillimin e çdo vlerësimi të rrezikut/nejës së të burgosurve. Manifestimi i besimeve ekstremiste nuk është në vetvete i rrezikshëm. Bëhet e rrezikshme kur besime ose mendime të tilla manifestohen në veprim, ose me qëllimin për të vepruar. Shpërndarja e të gjitha të dhënave në dispozicion sugjeron se një aspekt shumë pozitiv i projektit është se mjeti i VRrN-së është krijuar nga grupet punuese në të gjithë përfituesit për të marrë parasysh këto parime të rëndësishme.

Në balancimin e të dhënave midis dokumenteve të ndryshme të zhvilluara si pjesë e këtij projekti, dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar pjesëmarrësve, për të udhëhequr politikën e ardhshme në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, kjo pikë e fundit është e rëndësishme që përfituesit të sigurojnë që mjetet e VRrN-së masin çfarë ata synojnë të masin dhe kërkohet monitorim i vazhdueshëm për të arritur këtë.

Siç qëndrojnë, mjetet e VRrN-së të zhvilluara gjatë këtij projekti u përmbahen udhëzimeve të tilla. Ato bazohen në literaturën empirike të faktorëve shtytës, tërheqës dhe personalë dhe përfituesit duhet të kujdesen në ndryshimet ose zhvillimin e mëtejshëm të mjeteve të tyre që këto parime të respektohen. Duhet të ketë edhe disa dispozita për të rinovuar vazhdimisht bazën e njohurive në lidhje me këto mjete për të siguruar që ato bazohen në gjetjet më të fundit empirike. Partneriteti me një universitet apo institucion akademik do të ishte shumë i dobishëm në këtë fushë. Ka prova të kufizuara deri më tani se ekziston një vazhdimësi midis mendimit radikal dhe veprimit terrorist, i cili në shumë juridiksione është përdorur për të mbështetur legjislacionin në penalizimin e 'ekstremizmit jo të dhunshëm'. Prandaj, çdo ndryshim në mjetet e VRrN-së duhet të përfshijë ekspertë në këtë fushë.

Për ekstremizmin e frymëzuar fetarisht, është e rëndësishme të mos ngatërrohen njerëzit që mund të kenë (ri)zbuluar besimin e tyre me njerëz që kanë zhvilluar pikëpamje radikale. Shumica e njerëzve që konvertohen ose kthehen (p.sh. në Islam) gjatë burgimit, po e bëjnë këtë për motive individuale paqësore ose për t'u lidhur me një grup të burgosurish të tjerë. Megjithatë, paragjykimet rreth lidhjes ndërmjet fesë dhe ekstremizmit mbeten të pranishme dhe mund të pengojnë vlerësimin e mirë të rrezikut. Mjetet e shqyrtimit dhe mjetet e VRrN-së janë po aq të mira sa individit që i administron ato, kështu që trajnimi i vazhdueshëm i stafit dhe ngritja e shkathtësive duhet të jenë pjesë e politikave që lidhen me këtë fushë. Paragjykimet dhe frika mund të çojnë në raportim të tepruar dhe ndërveprime negative, të cilat nga ana tjetër mund të minojnë çdo përpjekje për mosangazhim nga përfituesit.

Sigurimi i vlefshmërisë dhe besueshmërisë së vazhdueshme të mjeteve është thelbësor në marrjen e vendimeve të bazuara në prova. Megjithatë, deri më sot mjetet e zhvilluara në kuadër të këtij projekti nuk kanë aftësi parashikuese (të jenë në gjendje të parashikojnë nëse një akt terrorist apo ekstremizmi i dhunshëm mund të ndodhë në të ardhmen). Kjo ishte jashtë qëllimit të këtij projekti dhe kërkon shumë vite analizash dhe rezultatesh statistikore, kryesisht të bazuara në normat e përsëritjes së shkeljes për të qenë në gjendje të përcaktojnë natyrën parashikuese të mjeteve. Aktualisht nuk ka asnjë mjet për vlerësimin e rrezikut me cilësi parashikuese për VEP-ët. Për sa i përket menaxhimit të burimeve dhe planifikimit të individualizuar të trajtimit, mjetet kanë dobi të mirë dhe duhet të monitorohen vazhdimisht për këtë kërkesë të përshtatshme për qëllimin. Është e rëndësishme gjatë zhvillimit të politikave dhe legjislacionit rreth vlerësimit të rrezikut që çështja e pëlqimit të informuar të bëhet e qartë. Të burgosurit kanë të drejtë të refuzojnë të intervistohen dhe nuk mund të ndëshkohen për këtë. Asnjë konkluzion në lidhje me rrezikun ose rrezikshmërinë nuk mund të merret me siguri nga refuzimi i një të burgosuri për t'u përfshirë në procesin e intervistimit. Disa përfitues ose nuk ia kanë treguar të burgosurit arsyen e intervistës ose kanë sugjeruar një arsye tjetër në rastet kur të burgosurit refuzojnë ose u kanë treguar të burgosurve të tjerë për intervistën. Kjo është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe të gjitha politikat në vazhdim duhet të pasqyrojnë nevojën për pëlqim të informuar në procesin e intervistës. Trajnimi i vazhdueshëm në intervistën motivuese mund të ndihmojë për të mbështetur stafin në zhvillimin e shkathtësive të mëtejshme në angazhimin e të burgosurve. Duke pasur parasysh dakordimin unanim midis të gjithë përfituesve se bashkëpunimi mes shumë-agjencish është thelbësor në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me radikalizimin, procedurat standarde të funksionimit do të ishin një pikënisje e mirë për të siguruar që ky proces të realizohet.

Qasja e menaxhimit të rastit e miratuar nga *BeH* dhe procesi i miratuar nga *Kosova* janë pikënisje të mira për këtë, duke siguruar që ky bashkëpunim mes shumë-agjencish gjithashtu informon nevojat e pjesës së mjetit të VRrN-së për të siguruar që VEP-ve t'u sigurohen mundësi për rehabilitim. Brenda fushëveprimit të bashkëpunimit mes shumë-agjencish, ekspertiza dhe informacioni mund të ndahen, rreziqet individuale të komunikohen në mënyrë të përshtatshme dhe të hartohen plane veprimi.

⁸Rita Augestad Knudsen (2020) *Matja e radikalizimit: konceptualizimet dhe praktikat e vlerësimit të rrezikut në Angli dhe Uells, Shkencat e Sjelljes së Terrorizmit dhe Agresionit Politik*, 12:1, 37-54, DOI: 10.1080/19434472.2018.1509105

Secili pjesëmarrës në takimin e grupit punues tematik rajonal (GP) përfitoi shumë nga shembujt e dhënë nga përfituesit individualë të punës mes shumë-agjencish dhe u ra dakord që ky ishte një standard për të cilin duhet punuar të gjithë përfituesit.

Ndërsa do të diskutohet më tej në seksionin e trajnimit të këtij raporti, rrjeti "Iniciativa Holistike për Parandalimin e Radikalizimit" për trajnime të vazhdueshme dhe shkëmbim njohurish në Ballkan, vendet e Evropës Jugore dhe Lindore, qëllimi i të cilit është të zhvillojë një rrjet për trajnime të vazhdueshme dhe shkëmbim njohurish në Ballkan, vendet e Evropës Jugore dhe Lindore, duhet të përdoret për të informuar çdo udhëzues politikash, si dhe duhet të përditësohet informacioni nga RrNR-ja.

B. Niveli i zbatimit

Siç thekson Silke, burgu nuk e reformoi ish-udhëheqësin e Al-Kaidës, Ayman al-Zawahiri, nuk e rehabilitoi atë dhe sigurisht që dështoi ta deradikalizojë atë. Burgu ia doli vetëm ta bënte atë më të rrezikshëm" (Silke, 2014b, fq. 108). Për këtë qëllim, përfituesit kërkojnë sisteme që të sigurojnë që praktika e tyre e rehabilitimit mund të monitorojë ata që janë më në rrezik për t'u radikalizuar ose për të radikalizuar të tjerët. Kjo përfshin sigurinë dinamike. Termi "siguri dinamike" mund të përkufizohet dhe kuptohet si veprime që kontribuojnë në zhvillimin e marrëdhënieve profesionale, pozitive midis anëtarëve të stafit dhe shkelësve. Nisur nga kjo, stafi i sigurisë i njeh ata që janë në krye të tyre më shumë sesa personeli psikosocial dhe janë një burim i vlefshëm informacioni për të kontribuar në VRRN. Departamenti i sigurisë duhet t'u ofrojë vlerësuesve të rrezikut një raport të shkurtër mbi çdo faktor përkatës që rrethon sigurinë që mund të ndikojë në rezultatin e tyre të VRRN-së. Inteligjenca e nevojshme për shqyrtimin e saktë dhe vlerësimin e rrezikut përfshin elementët e mëposhtëm: **E kaluara** - Bazuar në veprën penale dhe shkelje të tjera, shkaktarë dhe kontekste të situatës. Cilët janë faktorët e njohur të rrezikut? Ky informacion mund të vijë nga një shumëllojshmëri burimesh, duke përfshirë transkriptet e gjykatës, informacionin e sigurisë/policisë, punën sociale dhe historinë penale.

E tashmja - Skanimi mjedisor. Sjellja aktuale, kontekstet e situatës dhe faktorët mbrojtës. Kjo ndodh në mjedisin e burgut dhe ekziston një kërkesë për të qenë specifik se çfarë dhe pse janë të rëndësishëm këta tregues të sjelljes. **Balancimi i vendimeve:** Duke pasur parasysh këto ndryshime dhe lidhjen e tyre me sjelljet në të kaluarën, çfarë duhet bërë që të jetë funksionale për të menaxhuar dhe/ose për të zbutur këtë rrezik? Rritja e monitorimit duhet të përfshijë atë që monitorohet. Një çështje e mëtejshme për përfituesit në sigurimin e inteligjencës së mirë të burgjeve lidhet me sjelljet paralele të shkeljes (SPSh). SPSH ndodh kur një individ demonstroi një sekuençë sjelljesh, mendimesh ose emocioneve, që i ngjan mendimeve ose emocioneve të sjelljes që ishin të pranishme në çuarjen në shkelje dhe/ose gjatë shkeljes së tyre (Wakama, 2008)⁸. Kur vlerësojnë mjetin e VRRN-së, vlerësuesit duhet të kenë parasysh këtë koncept dhe nëse ndonjë sjellje mund të jetë SPSH.

Sikurse **Shqipëria, BeH** ka sugjeruar një mekanizëm më formal të mbledhjes së informacionit, si databazë qendrore. Pika e vendosur e kontaktit në çdo burg duhet të trajnohet në analizën e inteligjencës për të përmirësuar produktet e inteligjencës dhe ndoshta për të ngarkuar personelin me informacion shtesë.

Në kushtet e një qasjeje shumë-disiplinore, në **Kosovë** ka bashkëpunim të ngushtë me stafin korrektues, mbikëqyrësit e pavijonit, drejtuesin e pavijonit, inteligjencën e institucionit, në rast nevojë kontakt direkt me Drejtorin e Inteligjencës. Ka takime të rregullta mujore të cilat përfshijnë të gjithë grupin që punon me VEP. Punonjësit socialë plotësojnë të dhënat në databazën e cila monitorohet nga agjencitë dhe zyrtarët socialë marrin informacion direkt nga Drejtori i Inteligjencës, i cili është edhe përgjegjës për punën për këtë kategori të burgosurish.

⁸shih Dokumentin e Diskutimeve, Shqyrtimi dhe VRRN-ja, dhjetor 2020, faqe 5

Të dhënat për vlerësimet individuale të radikalizimit ndahen me Drejtorin e Inteligjencës me email dhe nëse dyshoni, atëherë këto të dhëna ndahen me drejtuesin e pavijonit dhe stafin e inteligjencës. Ky model i praktikës më të mirë mund të miratohet lehtësisht nga përfituesit e tjerë. Rritja e aftësisë së inteligjencës brenda burgut për të përfshirë analizën e informacionit dhe krijimin e një mekanizmi komunikimi me agjencitë e jashtme për informacion të mëtejshëm dhe mbledhjen e informacionit.

Të burgosurit nuk duhet të intervistohen për qëllime të një vlerësimi të VRrN-së. Për sa i përket pëlqimit të informuar, të burgosurve duhet t'u tregohet qëllimi i intervistës dhe natyra vullnetare e pjesëmarrjes. Ndërsa ekziston gjithmonë një rrezik, ata nuk do të përfshihen; ata kanë të drejtë të dinë se për çfarë po intervistohen dhe të refuzojnë. Nëse ka informacion të mjaftueshëm për dosjen, atëherë VRrN-ja mund të notohet. Nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm të dosjeve në nivel legjislativ, ky informacion duhet të filtrohet në mënyrë që situata të mund të monitorohet. VRrN duhet të pasojnë mjetin e shqyrtimit nëse indikohet. Ai mund të përfundojë gjatë fazës së pranimit, por gjithashtu duhet të rishikohet rregullisht gjatë gjithë dënimit të të burgosurit.

Gjatë fazës së pilotimit dhe në grupet e diskutimit, përfituesit njëzëri raportuan se procesi i intervistimit motivues kërkon kohë. Rekomandohet që intervistuesi ta ndajë intervistën në dy pika me nga afërsisht 45 minuta secila. Qëllimi i mjetit të VRrN-së është të përdorë gjykimin e strukturuar profesional (GjSP) për të përcaktuar se çfarë niveli të përpjekjeve rehabilituese duhet të aplikohet për të burgosurin, i cili mund të përmbledhet në një plan trajtimi. Idealisht, ky plan trajtimi duhet të plotësohet nga një ekip shumë-disiplinor. Si i tillë, në fazën e zbatimit është e rëndësishme të kuptohet se përfundimi i një vlerësimi të rrezikut dhe plani pasues i trajtimit kërkon kohë dhe durim. Ishte shumë e dukshme gjatë projektit që shpesh personelit nuk iu caktua kohë e mjaftueshme për ta bërë këtë dhe pritej të bënte vlerësimin e rrezikut në krye të detyrave të tyre normale. Për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe vlerësimin e saktë të rrezikut, politikat duhet të reflektojnë se ndarja e punës së stafit duhet të marrë parasysh se ata kërkojnë kohë për të bërë këto vlerësime.

Besueshmëria ndërmjet vlerësuesve (dy persona që vlerësojnë të njëjtin të burgosur) është një metodë e dobishme për të vlerësuar të burgosurin për sa i përket besueshmërisë së mjetit që përdoret, por jashtë kësaj, është një metodë e mirë për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të stafit për sa i përket vlerësimit të rrezikut, ku ata kanë një mundësi për të diskutuar informacionin e dosjes dhe të burgosurit. Përmbajtja e trajnimit harrohet me kalimin e kohës, prandaj është e rëndësishme të sigurohet që stafi të ketë mundësi dhe kohë për të mbajtur të përditësuar shkathësitë e tyre për vlerësimin e rrezikut. Ndërtimi i disa kontrolleve të besueshmërisë ndërmjet vlerësuesve nga kolegët është një mënyrë e mirë për ta arritur këtë.

TEME

2

Rehabilitimi, trajtimi dhe shkëputja nga dhuna e të burgosurve të radikalizuar dhe ekstremistë të dhunshëm



Pasqyrë analitike e gjetjeve, zhvillimeve dhe praktikës në Ballkanin Perëndimor

Të gjashtë përfituesit pranuan rëndësinë e rrezikut që vjen nga radikalizimi në burgje dhe nevojën për të zbatuar programe efektive rehabilitimi për të shkëputur dhe deradikalizuar individët nga përdorimi i dhunës. Të gjithë përfituesit kanë programe të përgjithshme rehabilitimi të institucionalizuara në kuadër të shërbimeve të tyre korrektuese. Programet rehabilituese të zbatuara brenda burgjeve të ndryshme në të gjashtë përfituesit pjesëmarrës ndryshojnë, në rastin e *Maqedonisë së Veriut* dhe *BeH-së* që theksojnë një komponent të programit të zhvillimit kognitiv. Në *Maqedoninë se Veriut* programi i zhvillimit kognitiv u pilotua në tri institucione penitenciare. Programi i rehabilitimit të përgjithshëm i *Shqipërisë* fokusohet në zbatimin e një programi kombëtar arsimor dhe shkathtësive të tjera profesionale për të burgosurit. Ky është i ngjashëm me programin e rehabilitimit në *Kosovë* ku ekziston një program i përgjithshëm (i detyrueshëm), i cili përfshin si shkathtësitë kognitive dhe disa trajnime për shkathtësi profesionale, si dhe një program arsimor specifik (opsional). Përfituesit ishin të ngjashëm në atë që përpjekjet e tyre për të trajtuar radikalizimin kishin për qëllim shkëputjen nga dhuna dhe jo deradikalizimin dhe se përpjekjet për rehabilitim në zhvillim ishin të orientuara drejt kësaj. Elementet kryesore të përbashkëta për ndërhyrjet për VEP në të gjithë rajonin kishin për synim të siguronin që çdo plan rehabilitimi të individualizohet sipas rrezikut dhe nevojave të të burgosurve. Të gjithë përfituesit kanë, ose janë në procesin e zbatimit, një mjet i VRRN-së specifik për VEP për të përcaktuar nivelin e rrezikut dhe nevojën për çdo të burgosur individual, inputet e të cilit shërbejnë si bazë për zhvillimin e planit individual të rehabilitimit/trajtimit. *Shqipëria*, *Kosova* dhe *Serbia* kanë zhvilluar mjete specifike për VEP dhe programe individuale rehabilitimi për VEP në kuadër të Veprimit dhe i kanë pilotuar këto me sukses. Pilotët kanë dëshmuar funksionalitetin dhe zbatueshmërinë e këtyre mjeteve dhe programit individual të rehabilitimit brenda konteksteve të tyre penitenciare dhe specifike të tij, megjithatë janë identifikuar disa sfida të caktuara ndaj tyre duke u vënë plotësisht në praktikën e përditshme gjatë punës me VEP.

Sfidat për aplikimin e qasjes individuale të rehabilitimit ndaj VEP

Një nga sfidat kryesore të identifikuar nga të gjithë përfituesit ishte mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare të nevojshme për të kryer ndërhyrje rehabilitimi. Përveç burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe trajnimeve të tyre. Pjesëmarrësit e pranuan botërisht se nevojiten ngritja e kapaciteteve dhe trajnimet për personelin e burgjeve që punon me VEP. Siguria dinamike, e cila synon ndërtimin e marrëdhënieve të mira midis personelit të burgut dhe të burgosurve, u vu re se luan një rol të rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit dhe ndërtimin e besimit me VEP dhe duhet të përshtatet në të gjitha ndërveprimet me ta. Po ashtu u vu re se të gjithë përfituesit kanë burime të kufizuara kur bëhet fjalë për të ardhmen. Zhvillimi i shkathtësive dhe njohurive mbi proceset e shkëputjes nga dhuna dhe veçanërisht deradikalizimit, veçanërisht në lidhje me ideologjinë fetare për personelin e burgjeve u përsërit si nevojë në mënyrë kritike nga praktikuesit. Çështja se sa janë të motivuar VEP-ët për të marrë pjesë në LEDh, deradikalizim ose lloje të ngjashme ndërhyrjesh, ngriti disa çështje kyçe. Në disa raste, ka ose mungesë ose dëshirë minimale për të ndryshuar. Disa VEP mbajtën qëndrime komplekse dhe nuk respektuan legjitimitetin e autoriteteve të burgjeve dhe ligjit. Një mundësi në dukje e mundshme për përfshirjen e imamëve në procesin e rehabilitimit u hodh poshtë nga disa VEP, të cilët protestuan se po bëheshin përpjekje për të ndikuar në besimet e tyre fetare. Është thelbësore kur përfshihen udhëheqësit fetarë në përpjekjet e rehabilitimit që ata të trajtohen mirë. Është me rëndësi kyçe që figura të tilla të kuptojnë se si të rrisin interesimin e VEP-ve në procesin e vënies në dyshim të besimeve të tyre dhe në iniciimin e ndryshimeve të brendshme. Pavarësisht nëse VEP-ët janë aktivisht rezistent në këtë fazë, hapi i parë i përqendruar te motivimi dhe besimi ishte shpesh pjesa më e vështirë e rehabilitimit. Krahas kësaj, një avantazh i rëndësishëm mund të fitohet duke ofruar programe që kanë theks kryesisht të formimit profesional ose të orientuar drejt punës.

I zakonshëm për të gjithë përfituesit ishte përdorimi i një ekipi shumë-disiplinor (EshD) për t'u përfshirë në rrezikun/nevojat dhe rrjedhimisht planifikimin e trajtimit për çdo të burgosur, i cili është në përputhje me standardet e praktikave më të mira ndërkombëtare. Një pikëpamje e përbashkët ndahet se programet e rehabilitimit për VEP nuk duhet të jenë të kufizuara ose të fiksuara në kohë, por duhet të jenë të vazhdueshme dhe të rishikohen rregullisht për të përcaktuar çdo lëvizje në rrezik dhe nevojë – qoftë të rritet ose të ulet.

Të gjithë përfituesit mbështetën përfshirjen e formimit profesional si një metodë e ndërtimit të shkathtësive, por edhe si metodë shpërqendrimi nga pikëpamjet e radikalizuara. Kishte një konsensus universal që çdo përpjekje drejt rehabilitimit duhet të përfshijë shërbime të integruara, në mënyrë ideale me një njësi të specializuar që koordinon këto shërbime si në burg ashtu edhe në komunitet. Një dakordim i përbashkët ishte shmangia e praktikës së besimeve sfiduese të drejtpërdrejta, por më tepër përdorimi i një qasjeje motivuese për të eksploruar dallimin midis vlerave thelbësore dhe identitetit të individit përpara radikalizimit dhe identitetit të tyre të ri si rezultat i radikalizimit. Përderisa kishte disa dallime në faktorët shtytës, tërheqës dhe personalë ndërmjet përfituesve, shumica e tyre ndanë përvoja të ngjashme me këta faktorë me plane për të përfshirë metoda për përdorimin e këtyre përvojave të VEP-ve individuale me faktorë të ndryshëm shtytës/tërheqës/personalë. Një temë tjetër e zakonshme ishte niveli i çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD) dhe ankthi në luftëtarët e rikthyer, për të cilin u konfirmua se kërkohet më shumë kontribut specialistësh nga psikologët dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor si pjesë e qasjes shumë-disiplinore. Rekomandohet që vlerësimi për këtë të standardizohet gjatë periudhës së pranimit dhe të jetë pjesë e vlerësimit të rrezikut/nevojave, veçanërisht për identifikimin e çdo faktori të përgjegjës që mund të ndikojë në aftësinë e individit për t'u përfshirë në përpjekjet e rehabilitimit.

Përpjekjet për të ofruar oferta ndërhyrjesh për të burgosurit e radikalizuar vijnë me një sërë sfidash të ndryshme për menaxhimin e të burgosurve të tjerë, sepse shumë prej tyre kanë pikëpamje të rrënjosura thellë për botën. Një temë e zakonshme ishte nevoja urgjente për 'përmirësimin' e stafit për të menaxhuar të burgosurit si në një kontekst trajtimi, por edhe në baza ditore. Duhet mbajtur mend se rehabilitimi i të burgosurve nuk kufizohet vetëm në terapi apo trajtim, por në një mjedis ideal ndodh në një kontekst në të cilin i gjithë personeli në burg po punon drejt të njëjtit qëllim.

Ndër sfidat e përbashkëta në të gjithë rajonin ishte nevoja për të shtuar burimet njerëzore dhe për të investuar në trajnimin e stafit, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen adekuate të stafit të angazhuar në programet e rehabilitimit. Gjatë kohëzgjatjes së Veprimit, u zhvillua dhe u pilotua një metodologji individuale rehabilitimi për VEP. Shkathtësitë për të realizuar këto programe janë të detyrueshme. Trajnimi në intervistim motivues është trajnim prioritar për të cilin personeli ka nevojë. Një temë që u shfaq ishte humbja e mundshme, me kalimin e kohës, e njohurive të marra gjatë trajnimit, e cila mund të rezultojë në mungesë besimi për zbatimin e pilotit, përveç sfidave të tjera që lidhen me rialokimin e stafit dhe qarkullimit të stafit, dhe zvogëlimin e mbështetjes së menaxhmentit.

Ky është një aspekt kritik sepse rehabilitimi fillon kur i burgosuri hyn për herë të parë në burg, qoftë në paraburgim apo i dënuar. Në këtë kontekst, seancat e trajnimit u pritën si metodë shumë e mirë për të ofruar trajnim në kohë reale në përdorimin e shkathtësive.

¹⁰Në Shqipëri, Serbi dhe Kosovë, mjetet/programet specifike për VEP u pilotuan me sukses në kuadër të Veprimit.

Kapacitetet rehabilituese në përfituesit

Kosova

Në fillim të Veprimit, në **Kosovë** tri programe të ndryshme vullnetare janë drejtuar nga psikologë, punonjës socialë dhe imamë. Programet synonin çështjet e shëndetit mendor, këshillat fetare, ndërtimin e shkathtësive kognitive, edukimin dhe trajnimin e shkathtësive profesionale, aktivitetet kreative dhe rekreative dhe angazhimin e familjes. Përveç kësaj, janë tri punëtori ku VEP mund të trajnohen dhe të marrin certifikatë në profesionin përkatës. Veçanërisht, certifikata nuk ka emrin ose logon e burgut në të, në mënyrë që të reduktojë stigmën për VEP pas kthimit në vendin e punës. Më parë, pjesëmarrja e VEP në programin e rehabilitimit ishte dekurajuar nga liderët ideologjikë të popullatës së VEP-ve, të cilët u bënëin presion të tjerëve që të mos bashkoheshin me ta. Heqja e këtyre individëve me rrezik të lartë dhe me ndikim të lartë rezultoi në bashkëpunim dhe pjesëmarrje më të madhe të VEP-ve të tjerë të mbetur.

Në kuadër të Veprimit aktual, u zhvilluan metodologji dhe udhëzime për një program rehabilitimi specifik për VEP, të cilat u pilotuan në Burgun e Dubravës dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë në **Kosovë**. Ky program u pilotua duke përdorur një qasje shumë-disiplinore. Programi i rehabilitimit është i ndarë në dy seksione që pasqyrojnë praktikën më të mira ndërkombëtare në ndërhyrjet me VEP. Seksioni i parë fokusohet në orientimin e të burgosurit drejt jetës së burgut, pajtimin me dënimin e tij/saj dhe ndërtimin e raportit/besimit me lehtësuesin. Seksioni i dytë mbulon të gjithë procesin e vuajtjes së dënimit (shih Manualin e Rehabilitimit të RrNR-së). Pjesëmarrja paraprihet nga një vlerësim i detajuar i rrezikut dhe nevojave që lidhen me rehabilitimin duke përdorur një listë kontrolli për identifikimin dhe regjistrimin e tyre. Sesionet përfshijnë një spektër të gjerë elementësh dhe trajtojnë zhvillimin e vetëkontrollit, përvetësimin e shkathtësive kognitive dhe fokusin e vetë-rregullimit emocional. Në përgjithësi, lehtësuesit ishin të kënaqur me programin e rehabilitimit, megjithatë ata kanë shprehur shqetësimin se sa kohë u është caktuar lehtësuesve për të realizuar programin në krye të detyrave të tyre normale. Një koment tjetër nga përfituesi flet në favor të nevojës për trajnime të mëtejshme të stafit për të realizuar programe të tilla, veçanërisht për shkak se rotacioni/ndërrimi i stacioneve të detyrës për personelin është i shpeshtë.

Shqipëri

Në fillim të Veprimit rajonal, në **Shqipëri** programet e ndërhyrjes rehabilituese ishin në fazat fillestare pasi programi nuk ishte zbatuar deri më tani. Siç është vërejtur nga përfituesit e tjerë, VEP-ët e dënuar shpesh nuk pranojnë autoritetin e personelit të burgut, gjyqësorit dhe aktorëve të tjerë zyrtarë. Kjo ka çuar në një nevojë të konsiderueshme për më shumë trajnime të stafit se si të ndërveprojnë në mënyrë më efektive me VEP-ët, veçanërisht për t'i motivuar ata të marrin pjesë në ndërhyrjet rehabilituese. Kishte gjithashtu shqetësime nëse do të përfshiheshin VEP-ët në aktivitetet e rehabilitimit të dizajnuara për jo-VEP. Programet e rehabilitimit në **Shqipëri** kanë disa objektiva dhe metoda të ndërlidhura për arritjen e tyre. Ato përfshijnë një fokus në sjelljen agresive dhe kontrollin e agresionit; zhvillimi i shkathtësive kognitive të lidhura me këtë; dhe një modul për përmirësim motivues për të inkurajuar angazhimin me ndërhyrjet.

U vu në dukje se personeli i burgut i përfshirë në këtë proces kishte sasi të ndryshme trajnime dhe se personeli shpesh transferohet ndërmjet roleve dhe nuk ka një program trajnime bazë. Në shtator 2022, pilotimi i mjeteve/programeve specifike për VEP të zhvilluara në kuadër të Veprimit filloi në dy burgje shqiptare dhe u finalizua në fund të nëntorit 2022.

¹¹Programi i rehabilitimit filloi në fund të shtatorit 2021 dhe u mbështet gjatë gjithë kohës nga vizitat monitoruese/mbështetëse nga konsulentit vendas, përveç takimeve të trajnimit/mbështetjes me konsulentin ndërkombëtar.

Bosnjë e Hercegovinë

Në fillim të Veprimit rajonal, në **BeH** u realizua planifikimi dhe analiza individuale e personalitetit për çdo VEP dhe u nda në 8 pjesë: arsimimi (shkolla fillore dhe e mesme), terapia e punës, dinamika familjare, aktivitete të tjera (sporti, kultura), puna individuale (lloji i punës me të burgosurin, mendimi i tij për veprën penale). Nëpërmjet projektit specifik për përfituesin, tashmë janë zhvilluar një sërë dokumentesh: Dokumenti i Politikës Strategjike dhe Plani i Veprimit për trajtimin e VEP-ve (2020 – 2025) dhe Strategjia e Menaxhimit të Stafit, dhe analiza ligjore dhe material trajnimi për aplikimin e Manualit të Sistemit të Menaxhimit të Rasteve për VEP. Në bashkëpunim me KIE-në, sistemi i burgjeve të **BeH-së** ka zhvilluar udhëzime specifike për menaxhimin e procesit të rehabilitimit të VEP-ve. Kjo ka përfshirë zhvillimin e gjithsej shtatë programeve të trajtimit, përkatësisht në fushat e: motivimit; qëndrimet, shkathhtësitë, zgjidhja e problemeve, emocionet, varësitë dhe programet e para-lirimit. Ndërsa kishte një theks në një komponent të programit të zhvillimit kognitiv, **BeH** përfshin gjithashtu aktivitete fetare dhe sportive përveç një sërë aktiviteteve kulturore. Një sistem i plotë manual dhe i menaxhimit të rasteve i është kushtuar rehabilitimit të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm në **BeH**. Praktika në **BeH** ka qenë mjaft i avancuar në drejtim të zhvillimit të mjeteve dhe ka qenë aktiv në zbatimin e trajnimeve dhe pilotimit në fushën e radikalizimit që nga viti 2018. Paketa e mjeteve dhe programi i rehabilitimit u rishikuan në dritën e praktikave më të mira ndërkombëtare. Megjithatë, sfidat me të cilat përballen në **BeH** duken të jenë logjistike pasi të burgosurit VEP u transferuan në burgun shtetëror dhe nuk kanë pasur qasje në ndonjë aktivitet kuptimplotë, gjë që shkel qëllimin dhe synimet e programit të rehabilitimit. Kjo është për shkak të ndryshimit me fokus në më shumë mbështetje për menaxhmentin dhe zbatimin e sistemit të menaxhimit të rasteve në ligj. Interesante, **BeH-ja** raportoi se mjeti i shqyrtimit kapi një të burgosur i cili nuk ishte në mbajtje për ndonjë vepër terroriste, por që megjithatë ishte radikalizuar, gjë që është një shembull i mirë se përse mjeti i shqyrtimit është një pjesë e rëndësishme e ndërlidhjes në procesin e rehabilitimit. Ekziston nevoja për edukim shtesë të personelit që të jetë në gjendje të zbatojë qasjen individuale të rehabilitimit.

Mal i Zi

Veprimi mbështeti zhvillimin e mjeteve/programeve specifike për VEP, por këto nuk janë pilotuar ende pasi nuk ka të burgosur të kësaj kategorie në sistemin penitenciar të **Malit të Zi** aktualisht. Ka pasur shumë pak trajnime për stafin për zbatimin e ndërhyrjeve rehabilituese për këtë kategori të burgosurish. Në **Mal të Zi** kishte disa programe të përgjithshme në përdorim dhe një grup programesh individuale për përdorim me të burgosurit me dënime të gjata. Procesi i rehabilitimit dhe trajtimit ndjek nevojat individuale që identifikohen dhe synojnë riintegrimin. Një pjesë e kësaj përfshin një proces të nxjerrjes së perspektivave të të burgosurve dhe stafi kërkon të sfidojë besimet që ndikuan në vendimet e tyre. Në punën e para-lirimit ka gjithashtu një fokus të fortë praktik që përfshin vëmendjen që i kushtohet shkrim-leximit, arsimit dhe formimit profesional. Një pjesë tjetër kryesore e punës ka të bëjë me marrëdhëniet familjare, dhe veçanërisht mbi pasojat e thyerjeve në to, të shkaktuara nga përfshirja e të burgosurit në vepra terroriste.

U pranua se kjo paraqet probleme të mundshme në rastet kur familjet kanë mbështetur ideologjinë ekstremiste, përfshirë këtu kur anëtarët e familjes u bënë luftëtarë të huaj terroristë (LHT). Krahas kësaj, ekziston një gamë e gjerë aktiviteteve të tjera programore, veçanërisht për të burgosurit që vuajnë dënime më të gjata (të cilat mund të jenë në intervalin 20-40 vjet në disa raste). Ofrohen seanca për kontrollin e zemërimit, seminare për fuqizimin dhe kur është e nevojshme për vepra penale seksuale. Të burgosurit gjithashtu mund të kenë qasje në aktivitete sportive dhe kulturore, dhe për disa qëllime kanë lidhje me agjencitë e komunitetit lokal dhe shërbimet fetare. Vëmendje i është kushtuar ndikimit që disa të burgosur, veçanërisht ata që vuajnë dënime të gjata për vrasje që përfshijnë nivele të larta brutaliteti, mund të kenë tek të burgosurit e tjerë dhe nevojës për të zhvilluar programe të specializuara për këtë grup.

Maqedoni e Veriut

Sistemi i burgjeve në *Maqedoninë e Veriut* zbaton ndërhyrje rehabilituese të projektuara posaçërisht për të burgosurit e radikalizuar bazuar në një draft metodologji rehabilitimi për personat e radikalizuar ku aplikohet trajtimi individual, me kohëzgjatje 12 muaj. Modulet fokusohen në zhvillimin e marrëdhënieve pozitive ndërmjet VEP-ve dhe përfaqësuesve fetarë dhe psikologëve, narrativës, mësimin dhe zhvillimit personal, vlerave dhe besimeve. Çdo modul përfshin përfaqësues fetarë, përfaqësues të komunitetit dhe organizata joqeveritare (OJQ) dhe zbatohet për VEP me rrezik të ulët deri mesatar. *Maqedonia e Veriut* gjithashtu ka zhvilluar tashmë një VRRN specifike e cila përdor një listë treguesish. Disa ndërhyrje ishin në faza të ndryshme zhvillimi, me disa të përfunduara ndërsa të tjerat ishin ende në zhvillim. Ato përfshinin punën për rritjen e moralit ose të vlerave, edukimin dhe trajnimin profesional. Ekziston një program tashmë i finalizuar me 44 sesione i ndarë në katër module (moduli 1: pesë muaj; modulet 2-3-4: dy muaj secili).

Disa pjesë të kësaj përfshijnë ushtrime në ndërtimin e besimit dhe ndryshim të narrativës drejt zhvillimit të identiteteve të reja prosociale. Lidhjet me familjet janë të përfshira në disa pjesë të procesit. Për fazën tjetër të procesit, fokusi kryesor po vendoset në zhvillimin e kanaleve të sigurta të komunikimit ndërmjet shërbimeve të burgut dhe të sigurisë. Pyetjet megjithatë mbeten edhe për përcaktimin e qëllimeve individuale si prosociale ose antisociale në varësi të perspektivave dhe besimeve. Për realizimin e programit, intervista motivuese është shkathtësi kyçe për të zhvilluar anëtarët e stafit. Ndërhyrja është e ndryshueshme në varësi të shkallës së vlerësuar të rrezikut, për rrezik të ulët = 3-4 muaj. Rrezik mesatar = 4-6 muaj. Rrezik i lartë = 6-12 muaj. Në pjesën hyrëse dhe më të madhe, punohet intensivisht në krijimin dhe ngritjen e lidhjeve që janë vendimtare për ecurinë e mëtejshme të programit, pastaj tri module: Narrativat me 6 seanca; Mësimi dhe zgjidhja e problemeve me 3 seanca; dhe Vlerat dhe vlerësimet me 4 seanca. Qëllimi përfundimtar i programit është të ndihmojë individin të rilidhet me të kaluarën e vet në mënyrë që pikëpamjet e tij ekstreme të bëhen më pak të theksuara. *Maqedonia e Veriut* ka vazhduar të raportojë probleme në zbatimin e fazës pilotuese të programit të tyre të rehabilitimit për shkak të një sërë faktorësh logjistikë. Është e rëndësishme të theksohet se ekziston një mjet shqyrtimi për radikalizimin dhe kjo duhet të zbatohet qartë për të zbuluar shenjat e radikalizimit përpara se ato të nguliten dhe të bëhen problematike. Pavarësisht nga faktorët logjistikë, edhe nëse vetëm një i burgosur i përshtatshëm mund të identifikohet për pilotin, kjo do të ishte shumë e dobishme për të përcaktuar nëse programi është i zbatueshëm në *Maqedoninë e Veriut*. Disa sfida lidhen me mungesën e mbështetjes nga strukturat drejtuese në disa institucione të burgjeve dhe motivimin e pakët të personave të dënuar për përfshirje në program për shkak të vetë natyrës së programit, i cili modifikohet për ndërveprim kokë më kokë dhe mund të zgjasë deri në 1 vit.

Serbia

Të vendoset një bashkëpunim më i mirë dhe më funksional me institucionet që mund të ofrojnë mbështetje për VEP.

Një nga masat që nevojiten janë trajnimet e vazhdueshme të stafit ekzistues të burgjeve, si dhe rritja e burimeve financiare për qëndrueshmërinë e Qendrës së Trajnimit.

Për të aplikuar siç duhet mjetet/programet dhe PSV-të, ne duhet të rrisim kapacitetet njerëzore në institucionet tona.

Është e nevojshme të përfshihen zyrtarë të tjerë shtesë në trajnimin për shqyrtimin dhe vlerësimin e rrezikut.

Të përfshihen sa më shumë aktorë dhe profesionistë të fushave përkatëse.

Është e një rëndësie të veçantë sepse kemi raste të përbashkëta me të gjitha vendet e rajonit dhe ndarja e arritjeve të vendeve përfaqësuese të lejon të kuptosh mundësinë e ofrimit të shërbimeve për këtë kategori dhe avancimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe ndarja e sfidave të tyre lehtëson për të mos u gabuar!

Nga të dhënat e mësipërme është e qartë se ndërkohë që ka pasur përmirësime, mbeten shumë nga çështjet e zbuluara gjatë diskutimeve në këto takime tematike rajonale, të raportuara në dokumentet përcjellëse të diskutimit. Në përgjithësi, këto mund të ndahen në kategori të caktuara, të tilla si kornizat ligjore dhe institucionale, bashkëpunimi institucional, procedurat dhe aktivitetet e përcaktuara për rastet e para-lirimit, dhe qasje më të centralizuara për ndarjen e informacionit.

Sfidat

Kuadri ligjor dhe institucional për përgatitjen për lirim

Kuadri ligjor dhe institucional për përgatitjen për lirim ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në të gjithë rajonin. Lloji i përgatitjes për lirim, afati kohor dhe çdo proces përmes kujdesit kanë qenë subjekt i shumë diskutimeve. **Kosova** mund të jetë shembull i praktikës së mirë në krijimin e mënyrave efektive në shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin ndërmjet agjencive të ndryshme duke përfshirë Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), Koordinatorin e P/LEDh, Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Policinë e Kosovës (PK), dhe Agjencinë Kosovare të Intelgjencës (AKI), të cilat të gjitha bashkëpunojnë në shkëmbimin e informatave dhe koordinohen duke u takuar rregullisht. Kjo është e rëndësishme pasi organizata të ndryshme në komunitet duhet të dinë se çfarë niveli rreziku po monitorojnë. Për përfituesit e mbetur u theksua nevoja për përshtatjen e një kuadri ligjor për të vijuar me shkëmbimin e informacionit ndërmjet subjekteve të ndërlidhura.

Shumica e këtyre përfituesve u përgjigjën se informacioni ndahet në formë letre dhe/ose elektronike. Shembulli nga **Kosova** siguron që databaza është një kanal kyç përmes të cilit informacioni i përditësuar ndahet rregullisht. Sapo informatat për datën e lirimit t'i bëhen të ditura nga gjykatat SHKK-së, ato i njoftojnë PK-në, AKI-në dhe MPB-në dhe ngarkojnë informacionin në databazë. Një plan lrimi zhvillohet të paktën 3 muaj përpara datës së lirimit. Përveç kësaj, vetë drejtori i SHKK-së gjithashtu këshillohet se si të ndajë informacionin në mënyrë efektive me institucionet e jashtme.

Serbia demonstroi gjithashtu praktikë efektive në atë që ka një departament specifik të dedikuar për para-lirim: 'Ekipi për Mbështetje dhe Mbrojtje', i cili ofron shërbime këshillimi dhe referimi për agjencitë përkatëse. Megjithatë, në përputhje me përfituesit e tjerë, ata kanë shprehur zhgënjimin në nivelin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet agjencive.

Ndërgjegjësimi dhe trajnimi

Përfituesit ranë dakord se VEP-të janë të stigmatizuara në komunitet dhe rruga e tyre drejt riintegrit të suksesshëm është dukshëm më problematike se ajo e popullsisë së përgjithshme të burgosurish, duke kërkuar një nivel shumë më të lartë mbështetjeje. Gjithashtu u ra dakord unanimisht se puna me familjen e VEP-ve ishte faktor i rëndësishëm në procesin e risocializimit, por që familja mund të ishte gjithashtu një faktor që mundëson kthimin e VEP-ve në aktivitete të mëtejshme terroriste, prandaj të kuptuarit e dinamikës së familjes ishte vendimtar. Përsëri, **Serbia** dha disa shembuj të mirë të mënyrës se si ata kanë punuar me familjet e popullatës së përgjithshme të burgosurish para lirimit të tyre dhe se si kjo ka çuar në një rritje të të kuptuarit të tyre të veprës së kryer tek organet përkatëse shtetërore në komunitetin e gjerë. Kishte një konsensus të qëndrueshëm midis përfituesve që i gjithë stafi që punon me VEP, duke përfshirë ata që ofrojnë shërbime në komunitet, kërkonte shumë më tepër edukim dhe trajnim në lidhje me rrugët drejt radikalizimit dhe një trajnim të përgjithshëm ndërgjegjësues. Për këtë qëllim, **Serbia** dha disa shembuj të mirë të shtrirjes së praktikës së tyre jashtë mjedisve korrektuese dhe policore për të përfshirë broshura ndërgjegjësuese edukative për shkollat dhe në nivel të organeve të tjera shtetërore. Ata kanë zhvilluar një program të veçantë trajnimi për policinë, i cili do të shtrihet më tej në komunitetin e gjerë.

Përgatitja për lirim

Ndërkohë që ka pasur përmirësime në ofrimin e planifikimit të para-lirimit gjatë projektit, siç qëndron, shumë përfitues ende nuk kanë plane formale para-lirimi, program para-lirimi ose procese që i paraprijnë lirimit të individit. Gjatë diskutimeve tematike rajonale, u ra dakord që përgatitja për lirim eventuale të të burgosurve të fillojë me pranimin në burg. Për sa i përket planifikimit të rehabilitimit, u ra dakord që rreziku dhe nevojat e tyre do të ishin dukshëm të ndryshme nga pranimi (pika A) deri te lirim (pika B). Disa përfitues theksuan se aktivitetet në përgatitjen për lirim nuk ndryshonin për grupin e VEP-ve në krahasim me të burgosurit e tjerë, por të gjithë përfituesit ranë dakord se disa aktivitete specifike do të ishin të dobishme për të mbështetur më tej VEP-në drejt lirimit.

Deri më sot, vetëm **Maqedonia e Veriut** zbaton PSV specifike të para-lirimit. **Shqipëria** është në proces të zhvillimit të programeve të tyre të para-lirimit për popullatën e përgjithshme të burgjeve, por nuk kanë programe specifike të para-lirimit për VEP. Një situatë e ngjashme ekziston për të gjithë përfituesit e tjerë. Përderisa disa kanë qasje të menaxhimit të rasteve etj, mungon një manual specifik i para-lirimit me udhëzime, aktivitete dhe protokolle të qarta për VEP. Më tej, ndërsa mjetet dhe ndërhyrjet janë pjesërisht të disponueshme, ato shpesh nuk janë të qasshme në formë manualesh dhe shpesh nuk janë të përshtatura posaçërisht për nevojat e VEP-ve.

Shërbimi sprovues

Në shumë përfitues, sipas legjislacionit aktual në fuqi, shërbimi sprovues në përgjithësi përfshihet vetëm nëse i burgosuri lirohet me kusht. Jashtë kësaj ata kanë përfshirje të kufizuar me të burgosurit. Për shembull, në **Shqipëri** sipas Nenit 59 të Kodit Penal, individit merr përsipër përgjegjësinë për të mos kryer veprë penale gjatë kohës që është në provë, por nuk është e qartë se si zbatohet kjo. Ngjashëm, në **Kosovë** shërbimi sprovues është përgjegjës për të burgosurit e liruar me kusht, megjithëse ka një program riintegrimi në Divizionin për Parandalimin dhe Riintegrimin e Personave të Radikalizuar, ku përfshihen shërbimet e ofruara nga institucionet përkatëse dhe përgjegjësitë e secilit prej tyre. Aktivitetet janë të përfshira në planet e punës së Divizionit sepse aktivitetet ndryshojnë në bazë të situatës. Ndërsa nuk ka programe specifike në vetvete, në Kosovë për çdo të burgosur zhvillohet një plan individual mbikëqyrjeje, i cili përfshin aktivitete riintegrimi dhe bashkim familjar.

BeH nuk ka shërbim sprovues. Një situatë e ngjashme ekziston në **Mal të Zi**. **Serbia** ofron një shembull të praktikës më të mirë në atë që zyrtari i shërbimit sprovues përfshihet në kalimin e një të burgosuri në komunitet afërsisht një vit përpara lirimit dhe jo më vonë se tre muaj përpara lirimit kur fillon faza e përgatitjes. Shërbimet sprovuese për të burgosurit e liruar janë të përgjithshme, pa shërbime specifike për VEP, por raportohet se nevojat individuale të VEP-it do të merren parasysh kur hartohet një plan lirim dhe riintegrimi. Këto mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në bashkimin familjar, aktivitetet fetare dhe nevojat që lidhen me punën. Ashtu si përfituesit e tjerë, në **Maqedoninë e Veriut** shërbimi sprovues përfshihet me të burgosurit që lirohen me kusht në komunitet. Në atë fazë përgatitet një program individual bazuar në instrumentin e rrezikut/nejave.

Si përmbledhje, ndërkohë që ka pasur një lëvizje gjatë këtij projekti, mbetet një mungesë e protokolleve të qarta, si ndërmjet shërbimit penitenciar dhe sprovues, ashtu edhe ndërmjet qendrave të punës sociale dhe shërbimit sprovues. Lirimi me kusht i VEP-ve është një shembull i mungesës së tillë të protokolleve në të gjithë rajonin dhe më shumë theks duhet t'i vendoset çështjes se nën çfarë 'kushtesh' është VEP-i konsiderohet i sigurt për lirim të hershëm ose me kusht. Siç u përmend më herët në seksionin e vlerësimit të rrezikut/nejave të këtij raporti, ai nuk ka cilësi parashikuese dhe për këtë arsye vendimet për lirim me kusht nuk mund të merren vetëm në bazë të kësaj.

Qendrat për punë sociale dhe përkujdesje sociale

Disa përfitues theksuan rolin jetik të "Qendrave të tyre për punë sociale", veçanërisht rolin e rëndësishëm që ato luajnë në ofrimin e ndihmës pas vuajtjes së dënimit për të burgosurit e liruar. U ra dakord që qendrat, të cilat drejtohen nga Ministrinë përkatëse të Punës dhe Zhvillimit Social, janë gjithashtu të rëndësishme për të forcuar komunitetin dhe qëndrueshmërinë shoqërore me parandalimin e radikalizimit në komunitet.

Në shumë raste shërbimi social është përfshirë vetëm kur janë kërkuar masa të detyrueshme nga gjykata ose kur janë përfshirë të miturit. Në shumë përfitues, ligji për shërbimet sociale nënkupton se nuk ka mbështetje specifike financiare ose përfitime të tjera (si strehimi social, ndërmarrje sociale, etj.) për të dënuarit e liruar, e lëre më për VEP-ët, përveç atyre që parashikon ligji për individët e cenueshëm në nevojë për ndihmë të përkujdesit social.

Ka prova që institucionet e vuajtjes së dënimit informojnë qendrat e kujdesit social kur i burgosuri do të lirohet (**BeH**), megjithëse nuk ka dispozita ligjore formale për këtë dhe në shumicën e rasteve nuk ka memorandume bashkëpunimi. Duket se shpesh ndodh që të burgosurit t'i drejtohen qendrave për punë sociale me iniciativën e tyre dhe jo me referim formal. Në **Kosovë**, Qendrat për Punë Sociale janë të përfshira në fazat e hershme për përgatitjen për lirim dhe ka një person

kontaktues në sistemin e burgjeve që koordinon kontaktet, që është praktikë e mirë. Ngjashëm, ndërsa ata kanë një numër të kufizuar të VEP-ve në *Mal të Zi*, është formuar një ekip për ofrimin e asistencës (EOA) me synimin për të mbështetur të burgosurit me sjellje ekstremiste me të dalë nga burgju. Në *Maqedoninë e Veriut* Ligji për Mbrojtjen Sociale nënkupton se ky proces ndodh pas liritimit të të burgosurit nga burgju dhe nëse ka nevojë për ndihmë sociale, por nuk ka dispozita për VEP. Ngjashëm, në Serbi Qendrat për Punë Sociale nuk janë të përfshira në mënyrë sistematike. Është interesante se gjatë rrjedhës së projektit u sugjerua nga anëtarët e GP-së që përfaqësonin aspektin e kujdesit social në Serbi, se duhet të krijohet një shërbim i veçantë në kuadër të shërbimit sprovues dhe MPB-së, i cili do të bashkojë institucionet e tjera relevante (p.sh., vetëqeverisjen lokale, arsimin, informimin, kujdesin shëndetësor, kulturën etj.), me qëllim krijimin e masave të përbashkëta dhe zhvillimin e programeve për të mbështetur të burgosurit e liruar. Kjo do të kontribuonte në një qasje të harmonizuar, të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse drejt deradikalizimit të ish-të burgosurve, pasi të lirohen. Kjo pikë e fundit do të ishte vërtet një shembull i praktikës së mirë dhe diçka për të cilën duhet synuar.

REKOMANDIME për asistencë para liritimit dhe pas vuajtjes së dënimit

A. Niveli i politikave dhe legjislativit

Ka mungesë të udhëzimeve të koordinuara dhe specifike në lidhje me ndihmën para liritimit dhe pas vuajtjes së dënimit. Në nivelin më themelor, kur hapet dera e burgut, të burgosurit duhet të dinë se ku po shkojnë, si do të arrijnë atje dhe kush do ta paguajë. Prandaj, është e domosdoshme që legjislativi dhe politikat për “kush bën çfarë, kur dhe ku” ndërmjet agjencive të ndryshme, të hartohen sa më shpejt që të jetë praktike.

Është një shqetësim i vërtetë që shërbimi sprovues përfshihet në një VEP vetëm nëse i nënshtrohet liritimit me kusht. Kjo i lë jashtë VEP-ët të cilët mund të vuajnë të gjithë dënimin e tyre përpara se të lirohen në komunitet dhe për këtë arsye nuk do të përfitojnë nga mbështetja e strukturuar për kalimin në komunitet. Literatura empirike tregon se kalimi në komunitet, qoftë me lirim të parakohshëm ose pas vuajtjes së dënimit, është një situatë me rrezik të lartë që duhet menaxhuar me kujdes. Për ata me lirim me kusht, kjo mund të ofrohet nga shërbimet sprovuese në bashkëpunim me aktorë të tjerë. Ndër mbështetjen që duhet të vihet në dispozicion, si për ata me lirim me kusht ashtu edhe për ata jo të liruar me kusht, është mbështetja e vazhdueshme nga punonjësit socialë, psikologët dhe aktorët e tjerë që mund të mbështesin proceset e tyre të riintegritimit.

Nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe vlerësimit të rrezikut, përfituesit duhet të jenë shumë të qartë se çfarë nënkuptojnë me termin “me kusht” dhe një kriter i caktuar për këtë duhet të bëhet i qartë. Për ata përfitues që ofrojnë lirim me kusht për VEP (*Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut*) përshtatshmëria e VEP-ve për këtë privilegj vlerësohet bazuar në bashkëpunimin e tyre me personelin e burgut dhe pjesëmarrjen në një program rehabilitimi. Vendimi nuk është marrë në bazë të vlerësimit formal të rrezikut të tyre për komunitetin, e cila duhet të bëhet në bashkëpunim me agjencitë e jashtme përkatëse, veçanërisht shërbimet e sigurisë që mund të kenë informacione që shërbimi penitenciar nuk është në dijeni. Prandaj, është thelbësore që të zhvillohen memorandume bashkëpunimi që marrin parasysh marrëdhëniet e punës ndërmjet organizatave të ndryshme, rolet dhe përgjegjësitë dhe protokollet për lirim ose lirimin e hershëm të një VEP-i në komunitet.

Një problem tjetër që ka tendencë ta komplikojë këtë çështje është se ndryshe nga juridiksionet e tjera ku roli kryesor i shërbimit sprovues është të sigurojë mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të personave në komunitet pas liritimit nga burgju ose si një sanksion alternativ me burg, shërbimi sprovues është ose në fillimet e tij ose është krijuar për të mbikëqyrur vetëm ata me lirim të parakohshëm ose me kusht nga burgju.

Në shumë përfitues, sistemet që kërkohen për mbikëqyrjen e komunitetit pas lirimit nga burgu janë në fillimet e tyre ose në fazat e hershme të zhvillimit. Këto duhet të zhvillohen më tej duke parë sistemet nga juridiksione të tjera dhe rolet dhe rregulloret e shërbimeve sprovuese. Rekomandohet që të krijohet një GP vetëm për këtë qëllim. Serbia dhe një shembull të mirë për këtë në vendosjen e sistemeve ndërmjet burgut dhe shërbimit sprovues për kalimin nga burgu në komunitet.

Dokumentet e diskutimit pasqyruan shqetësimet e disa pjesëmarrësve në lidhje me lirimin e drejtpërdrejtë nga mjediset e sigurisë së lartë në komunitet. Në shumë juridiksione, një proces i 'tërheqjes', ku të burgosurit akomodohen në kushte më pak të sigurta gjatë periudhës para lirimit, shihet si thelbësor në kalimin e suksesshëm nga kushtet e sigurta në komunitet. Për sa i përket menaxhimit të rrezikut dhe nevojave, kjo duhet të nxisë më tej politikën dhe procedurat në lirimin e VEP-ve.

Duke pasur parasysh nevojat e paraqitura nga VEP në burgje, është thelbësore që qendrat për punë sociale të përfshihen në përgatitjen për lirimin e VEP-ve dhe në përgatitjen e një plani individual për çdo VEP, si pjesë e një sistemi më të gjerë gjithëpërfshirës që siguron qasje holistike të koordinuar. Politikën dhe legjislacionin i ardhshëm duhet të kujdesen për këtë komponent të rëndësishëm në kalimin e VEP-ve në komunitet.

Pavarësisht ligjeve për mbrojtjen e të dhënave, duhet të miratohen procedura dhe udhëzime të qarta për ndarjen e informacionit ndërinstitucional, duke specifikuar detyrimet dhe detyrat e të gjithë aktorëve përkatës në fushën e ndihmës pas vuajtjes së dënimit dhe zhvillimin e ekipeve speciale për riintegrimin e VEP-ve. Këto duhet të përfshijnë marrëveshje që i referohen veprimeve të të gjithë aktorëve përkatës në zinxhirin e mbrojtjes dhe riintegrimin të ish-të burgosurve, por edhe për të ofruar ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme për anëtarët e familjes.

Politikën rreth rrezikut dhe nevojave duhet të detajohen në lidhje me lirimin e VEP-ve. Duhet të theksohet se VEP-ët paraqesin nevoja dhe rreziqe të ndryshme në lidhje me popullsinë e përgjithshme të burgosurish, prandaj është e rëndësishme që të kalohen përmes politikave dhe legjislacionit ekzistues për të siguruar që ato pasqyrojnë rrezikun dhe nevojat e paraqitura nga VEP. Për shembull, kur kohëzgjatja e dënimit me burgim përfundon, sa është kohëzgjatja dhe niveli i mbikëqyrjes së komunitetit që kërkohet për të menaxhuar rrezikun? Duke qenë se periudha pas lirimit të drejtpërdrejtë nga burgu është një fazë me rrezik të lartë për shumë të burgosur (jo vetëm për VEP), në shumë juridiksione ka një preferencë për lirimin e parakohshëm të të burgosurve në mënyrë që ata të jenë në gjendje të marrin mbështetje gjatë kësaj faze me rrezik të lartë dhe, në disa raste (për të burgosurit me rrezik të lartë), të monitorohen në rrethana më reale. Për shembull, kjo është pjesë e procesit MShA (Mbrojtje mes shumë agjencish) në MB dhe është diskutuar gjatë grupeve punuese rajonale. Duhet të mendohet pak për miratimin e një procesi të ngjashëm për të siguruar që rreziku dhe nevojat e VEP-ve mund të menaxhohen gjatë kalimit të tyre nga mbajtja në burg.

Të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë qendrat e kujdesit social, duhet të vazhdojnë sipas procedurave të përbashkëta dhe udhëzimeve të përbashkëta për ndarjen e informacionit mes shumë agjencish, duke specifikuar detyrimet dhe detyrat e të gjithë aktorëve përkatës në asistencën pas vuajtjes së dënimit dhe zhvillimin e shërbimeve speciale për riintegrimin e të burgosurve, duke përfshirë VEP-ët. Ka disa modele praktike më të mira të dhëna më sipër që mund të përfshihen në procedura të tilla.

Ka prova të mjaftueshme nga të gjithë përfituesit për të sugjeruar nevojën urgjente për legjislacion dhe politika për burime dhe trajnime për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve për punonjësit në të gjitha shërbimet sociale, duke përfshirë vetëqeverisjen lokale, arsimin, mbrojtjen e kujdesit

shëndetësor dhe të tjera, me fokus në nevojat për rehabilitim dhe riintegrim të ish-VEP-ve dhe familjeve të tyre. Ka prova të mjaftueshme për të sugjeruar se fokusi te familjet ka munguar në pjesën më të madhe të legjislacionit për VEP.

Në të gjitha sugjerimet për përmirësime, është e rëndësishme që të ketë udhëzime dhe procedura të qarta për mënyrën e vlerësimit të efektivitetit të masave të zbatuara.

B. Niveli i zbatimit

Së pari dhe më kryesorja, duhet të theksohet se periudha e para-lirimit kërkon një punë të konsiderueshme për stafin ekzistues nëse do të bëhet në mënyrë efektive. Koordinimi i brendshëm dhe i jashtëm, vlerësimi i rrezikut, trajnimi i shkathtësive dhe aktivitete të tjera kërkojnë kohë dhe burime. Stafin nuk mund të pritët që ta bëjë këtë duke ia shtuar ngarkesës normale të punës dhe kjo duhet të reflektohet në politikat për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe personelin e caktuar në role të tilla. Në mënyrë ideale, çdo burg do të kishte një departament të caktuar të para-lirimit ku ndodhin aktivitete të tilla. Natyrisht nëse numrat janë të ulët, koha e caktuar e një punonjësi në këtë departament do të ishte proporcionale.

Në nivel lokal, provat do të sugjerojnë që kur VEP-i të lirohet nga burgu, duhet të zhvillohen udhëzime të qarta dhe të detajuara në formën e PSV-ve për të pasqyruar nevojat imediate (akomodim, transport, shëndetësi, punësim etj.) në nevojat më afatgjata për riintegrim. Këto udhëzime duhet të pasqyrojnë në mënyrë ideale 6 muajt e fundit të burgut të të burgosurit dhe kush do të bëjë çfarë, kur dhe pse:

- Kryerja e analizave të nevojave individuale, rreziqeve dhe faktorëve të qëndrueshmërisë;
- Identifikimi i aftësive dhe burimeve financiare, mendore, fizike dhe sociale;
- Vendosja e qëllimeve reale për periudhën e pas-lirimit;
- Theksimi i ndonjë faktori të veçantë rreziku që bie në sy;
- Zhvillimi i propozimeve për trajtimin e shkathtësive që mund të shkaktojnë stres të konsiderueshëm dhe potencialisht të rezultojnë në regres ndaj modeleve të vjetra negative;
- Planifikimi i hapave të nevojshëm për të ofruar udhëzime në mbështetje të integritetit funksional;
- Zbatimi i orientimit bazë në strukturat përkatëse mbështetëse, dhe ndonjëherë – në varësi të sasisë së kohës së kaluar në burg – riorientimi bazë në një mjedis të jashtëm të ndryshuar thelbësisht.

Provat e disponueshme sugjerojnë se VEP-ët kërkojnë manual specifik të para-lirimit (si ai i aplikueshëm për popullatën e përgjithshme të burgjeve) që lidhet me nevojat e tyre. Kjo duhet të zhvillohet nga përfituesit duke përkrahur përmbajtjen e një kursi të tillë duke përfshirë trajnimin e shkathtësive dhe përgatitjen për seancat e lirimit me të burgosurit. Module të tilla si shkathtësitë e komunikimit, ndërgjegjësimi arsimor, shkathtësitë profesionale, shkathtësitë për të kërkuar punë dhe përmbajtje të tjera përkatëse.

Periudha e para-lirimit duhet të fillojë të paktën 6 muaj përpara lirimit dhe duhet të hartohen memorandume bashkëpunimi me ofruesit e shërbimeve komunitare, të cilët mund të lehtësojnë disa aspekte të këtij drejtimi, të njohin të burgosurin dhe t'u ofrojnë edukim të burgosurve se çfarë është në dispozicion në komunitet për të përmbushur nevojat e tyre. Planifikimi i para-lirimit duhet të përfshijë gjithashtu një proces vlerësimi i përditësuar i rrezikut/nevojave.

Në lidhje me sa më sipër, rekomandohet fuqimisht që përfituesit të shikojnë konceptin e programeve për 'dalje'. Programi i daljes është një term kolektiv që i referohet programeve dhe ndërhyrjeve që synojnë shkëputjen nga dhuna e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm/terroristë.

Programet e daljes mund të ofrohen nga OJQ-të ose qeveritë, ose në kombinim. Programet janë intensive (nga 6 muaj deri në 3 vjet), duke përfshirë një sërë ndërhyrjesh dhe formash ndihme për ata që dalin nga grupet ekstremiste. Në takimet tematike rajonale u prezantuan një sërë programesh që zhvillohen brenda dhe jashtë Evropës.

Është parë si praktika më e mirë tek disa përfitues të cilët kanë krijuar një koordinator të posaçëm për lirim të VEP-ve dhe rekomandohet që një i tillë të emërohet në çdo institucion penitenciar. Sistemi në **Kosovë** është një shembull i mirë. Riintegrimi social i VEP-ve kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumë-disiplinore, me koordinim të fortë midis palëve të ndryshëm të interesit të përfshirë. Në një kontekst operacional, për t'u përgatitur për të mbështetur VEP menjëherë pas lirit, organizatave partnere duhet t'u sigurohet qasje e hershme në burg për të filluar procesin e rehabilitimit sa më shpejt që të jetë e mundur dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të qëndrueshme me të burgosurin. Bashkëpunimi ndërmjet i të gjithë aktorëve (shtetërorë dhe joshetërorë) është thelbësor në aspektin e shkëmbimit të informacionit, mbështetjes publike dhe politike gjatë risocializimit. Bashkëpunimi ndërinstitucional mund të inkurajohet nëpërmjet transferimit më të qetë të njohurive ndërmjet të gjithë aktorëve, nga praktikuesit të politikëbërësit dhe studiuesit dhe anasjelltas. Qasja në informacionin e të burgosurve në databazë qendrore është një pikënisje e mirë për këtë proces dhe është diçka që përfituesit duhet të synojnë.

SHTOJCA 1

Kurrikula e përbashkët kornizë për trajnimin bazë dhe të avancuar të stafit të burgjeve dhe shërbimit sprovues

TRAJNIM BAZË		
ÇËSHTJET	PËRMBAJTJA	TË TRAJNETUARIT E SYNUAR
përkufizimi i radikalizimit/ ekstremizmit/terrorizmit	Jepni përkufizime të hollësishme të shtetit anëtar përkatës dhe mënyrën e zbatimit të termave.	të gjithë anëtarët e stafit, duke përfshirë në veçanti nivelin drejtues dhe guvernatorët e burgjeve
kuadri ligjor (kombëtar, ndërkombëtar)	Zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi për të burgosurit dhe grupet radikale.	
shenjat e radikalizimit	Hyrje në shenjat e ndryshme vizuale dhe të sjelljes të radikalizimit (përfshirë: veshjen, shenjat, flamujt, shprehjet verbale, librat, tatuazhet, etj.).	
çfarë të bëni/raportoni	Jepni një përshkrim të detajuar se çfarë shenjash duhet raportuar, kur duhet raportuar dhe për kë, gjithashtu krijoni një sistem të unifikuar dhe të qartë raportimi. Informacion në lidhje me rregulloret dhe proceset që duhen ndjekur kur janë vërejtur sjellje radikalizimi dhe/ose ekstremiste, duke përfshirë mandatin profesional të anëtarit të stafit, linjat e raportimit dhe proceset për reagime mbi raportimin.	
të kuptuarit e punës së ekipeve të trajtimit shumë-disiplinor (ETShD)	ETShD-të kanë një rol kyç në lidhje me ndërhyrjet lokale të synuara, stafi duhet të jetë i vetëdijshëm për mandatin, anëtarët dhe kompetencat e tij në mënyrë që të mbështesë punën e tyre.	
rëndësia e bashkëpunimit/kompetencave ndërsektorale	Anëtarët e stafit duhet të kuptojnë se të gjithë kanë një rol në deradikalizim, sektorë të ndryshëm takohen me të burgosurit në rrethana të ndryshme, kështu që të kenë mundësinë t'i vëzhgojnë ata në rolet e tyre të ndryshme. Rregullore për ndarjen e informacionit.	

ndërgjegjësimi/trendet dhe shifrat	Prezantimi i trendeve kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me radikalizimin. Njohuri të përgjithshme të ideologjive të ndryshme dhe botëkuptimeve ekstremiste.	të gjithë anëtarët e stafit, duke përfshirë në veçanti nivelin drejtues dhe guvernatorët e burgjeve
teknikat bazë të intervistimit	Anëtarët e stafit duhet të pajisen me mjetet bazë për t'u angazhuar në dialog me të burgosurit radikalë. (çfarë të thuash dhe çfarë të shmangësh)	
feja	Informacion në lidhje me dallimin ndërmjet sjelljes së moderuar fetare dhe treguesve të radikalizimit.	
përgatitja për lirim	Njohuri bazë për kujdesin e pastajmë dhe ndërhyrjet e pas-lirimit.	
nevoja të veçanta të grupeve të cenueshme (gratë, të miturit)	Nëngrupe të caktuara kanë nevojë për ndërhyrje të veçanta, për shkak të nevojave të tyre të veçanta, stafi duhet të jetë i vetëdijshëm për këto karakteristika të veçanta.	
kthimi i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT)	LHT-ët i janë nënshtruar përgatitjeve të veçanta, mund të kenë përvojë luftarake dhe shumica kanë vuajtur nga PTSD. Stafi duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë informacion shtesë.	
rëndësia e shkëmbimit të informacionit	Të kuptuarit e rëndësisë së shkëmbimit të informacionit gjatë projektimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve.	
Protokollet Standarde të Veprimt (PSV)	Stafi duhet të jetë i vetëdijshëm për ekzistencën dhe përmbajtjen e dokumenteve të brendshme specifike të radikalizimit dhe PSV-ve.	
parandalimi	Informacion rreth qasjeve që stafi mund të përdorë në rolet e tyre të përditshme për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshmërisë së të burgosurve ndaj ekstremizmit të dhunshëm.	

TRAJNIM I AVANCUAR		
ÇËSHTJET	PËRMBAJTJA	TË TRAJNETUARIT E SYNUAR
njohuri të thelluara të fesë, ideologjive, grupeve	Të kuptuarit e formave të ndryshme të lëvizjeve radikale fetare, politike ose etnike (lëvizjet e majta ekstreme, e djathta ekstreme, islamizmi, selefizmi, ideologjia tekfire, etj.)	<p>anëtarët e stafit që punojnë vazhdimisht me radikalët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • edukatorë/instruktorë • psikologë/punëtorë socialë • personeli mjekësor • personeli i caktuar i sigurisë; të tjerë
aleanca e punës dhe terapia kognitive e sjelljes (TGS)	Hyrje në TGS dhe strukturat e specializuara të bashkëpunimit duke përfshirë kolegët, përfaqësuesit fetarë, OJQ-të etj.	
menaxhimi dhe organizimi i popullatës së R/EDh	Të kuptuarit e faktorëve motivues dhe ndërtimi efektiv mbi faktorët individualë tërheqës/mbrojtës.	
ndërhyrje dhe programe të veçanta	Të kuptuarit e plotë të ndërhyrjeve dhe të menduarit sistematik. Realizimi i ndërhyrjeve specifike të de-radikalizimit dhe shkëputjes nga dhuna. Teknika që mund të përdoren për biseda të vështira për të lehtësuar shkëputjen nga dhuna dhe deradikalizimin	
puna me individë dhe familje	Hyrje në ndërhyrje të veçanta me përfshirjen e anëtarëve të familjes.	
menaxhimi i informacionit	Puna me informacione të ndjeshme dhe/ose të klasifikuara.	
mbrojtja dhe siguria	Menaxhimi i faktorëve të rrezikut të paraqitur nga radikalët (përfshirë PSV-të për ngjarje të veçanta, vetëmbrojtje, përdorim të forcës, teknika speciale të ndërhyrjes, negociata të pengjeve, etj.).	
monitorimi dhe vlerësimi	Përgatitja e vlerësimeve komplekse para lirimimit me kusht, pushimit në shtëpi. Si të ofrohen dhe interpretohen saktë qasjet e vlerësimit të rrezikut që lidhen veçanërisht me ekstremizmin e dhunshëm.	

SHTOJCA 2

Lista e kontrollit të para-lirimit

MENAXHIMI

- Krijoni Departamentin e Para-lirimit
- Krijoni një ekip të menaxherëve të rasteve
- Emëroni një menaxher të rasteve për çdo të burgosur të radikalizuar 6-12 muaj para lirimit

DEPARTAMENTI I PARA-LIRIMIT (MENAXHER I RASTIT)

- Zhvilloni një program të individualizuar daljeje për çdo të burgosur
- Kontaktoni organizatat e jashtme për nevojat e identifikuar të të burgosurve
- Organizoni takime të para-lirimit me organizata të jashtme 3 muaj përpara lirimit të të burgosurve
- Lidhuni me departamentet e ndryshme në burg për të mbledhur informacion mbi rrezikun dhe nevojat e të burgosurit.
- Sigurohuni që informacioni i përditësuar mbi rrezikun dhe nevojat e të burgosurit të jetë i disponueshëm në takimin e para-lirimit. Këtu përfshihen nevojat e sigurisë, shëndetit, psikosociale, profesionale, strehimi dhe sociale.
- Lidhja me Departamentin e Trajtimit për aktivitetet e para-lirimit
- Organizoni takime shumë-disiplinore të para-lirimit
- Lidhuni me Departamentin e Kujdesit Shëndetësor për raportin e shkarkimit dhe sigurohuni që të realizohet kontakt me ekipet e shëndetit mendor me bazë në komunitet, aty ku është e përshtatshme
- Lidhuni me shërbimet e komunitetit të varësive
- Lidhuni me anëtarët e familjes
- Mblidhni raportin përfundimtar nga njësia e risocializimit
- Mblidhni raportin e lirimit nga kujdesi shëndetësor dhe jepini të burgosurit
- 2-5 ditë para lirimit informoni Qendrën për Shërbime Sociale
- 2-5 ditë para lirimit informoni policinë lokale dhe shërbimet përkatëse të sigurisë

DITA E LIRIMIT

- Dokumentet e gjykatës kontrollohen për të siguruar datën e saktë të lirimit
- I burgosuri kontrollohet nga mjeku
- A ka i burgosuri transport deri ku do të shkojë?
- A ka i burgosuri veshje civile?
- A ka i burgosuri fonde të mjaftueshme për të mbajtur veten për disa ditë?
- Identiteti i të burgosurit kontrollohet me shkresat e gjykatës
- A ka i burgosuri dokument identifikimi?
- Jepini të burgosurit një takim me punëtorin social lokal
- Dokumentet kontrollohen me menaxherin e rastit
- I burgosuri lirohet

SHTOJCA 3

Regjimi shembull

Në vijim është një regjim shembull që mund të adoptohet për të orientuar gradualisht të burgosurin në realitetin e ri të jetës së burgut dhe për ta përdorur kohën e tij në mënyrë të duhur gjatë gjithë dënimit. Këto aktivitete shpjegohen më në detaje më poshtë.

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
Mëngjes	Orientim Vëzhgimi emocional. Sesioni individual i trajtimit	Orientim Vëzhgim emocional Aktivitete kulturo- edukative	Orientim Vëzhgimi emocional.	Orientim Vëzhgim emocional. Rregullimi emocional	Orientim Vëzhgimi emocional. Aktivitete fetare	Aktivitete krijuese	Aktivitete në natyrë
	Aktivitete në natyrë	Aktivitete në natyrë	Sport	Sport	Sport	Sport	Sport
Pasdite		Aktivitete edukative	Puna	Puna	Aktivitete në natyrë	Aktivitete në natyrë	Aktivitete në natyrë
	Sport/Terapia e artit	Intervista motivuese	Aktivitete në natyrë	Sesioni individual i trajtimit	Vetëdija	Puna	Aktivitete krijuese

Qëllimi i aktiviteteve për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm është që ata të jenë rehabilitues në vetvete dhe të shërbejnë si një shpërqendrim nga një ideologji (diçka neutrale) dhe metoda e zhvillimit të raportit me anëtarët e stafit në një mënyrë jokonfrontuese. Këto aktivitete duhet të përfshijnë:

- Aktivitete edukative
- Punë apo angazhim profesional
- Aktivitete fetare
- Përdorimi i organizuar i kohës së lirë (p.sh. ushtrime, sporte, grupe krijuese, etj.)
- Seanca specifike të trajtimit individual me një oficer trajtimi (programet e trajtimit).

a) Aktivitete edukative

Përderisa shumë VEP janë të arsimuar mirë aktivitetet edukative kanë ende një rol të rëndësishëm në procesin e shkëputjes nga dhuna nëse ato janë "neutrale dhe synojnë zgjerimin e pikëpamjeve të të burgosurve dhe largimin nga ideologjitë - zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik kundrejt të menduarit konkret.

b) Sportet dhe aktivitetet fizike

Sporti dhe aktivitetet fizike janë të rëndësishme në çdo regjim rehabilitimi, por për VEP-të këto ofrojnë një mundësi për të zhvilluar aftësitë e ekipit pro-social, ndjeshmërinë, raportin me instruktorët e sportit dhe një mënyrë jokonfrontuese për të zhvilluar një ndjenjë humanizmi tek VEP-të. Sporti dhe aktivitetet fizike janë gjithashtu të rëndësishme për reduktimin e stresit dhe ankthit te VEP-të (nivele të reduktuara të kortizolit dhe rritje të niveleve të serotoninës) dhe si rezultat, ata kanë më shumë gjasa të përfshihen në seancat individuale të trajtimit.

c) Aktivitete kulturore

Qëllimi i aktiviteteve kulturore është që ato të jenë informuese dhe t'u mundësojnë VEP-ve të mendojnë ndryshe për veten dhe të tjerët. Përdorimi i bibliotekës, të kesh një grup tematik specifik për të prezantuar idetë dhe vlerat e kulturave të tjera janë mënyra të thjeshta, por efektive për të edukuar VEP-të mbi kulturat e tjera në një mënyrë jo sfiduese.

d) Angazhimi në punë

Angazhimi në punë ose aktivitete profesionale është një pjesë e rëndësishme e procesit të rehabilitimit dhe rezulton në një sens qëllimi dhe agjencie. Shpenzimi i orëve pa ndërprerje pa asgjë për të bërë rezulton në mërzitje dhe rritje të ankthit dhe zhgënjimit, gjë që nuk inkurajon shkëputjen nga dhuna. Puna e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm në burg duhet të jetë e qëllimshme dhe aty ku është e mundur, të rrisë aftësinë për të fituar punësim të qëllimshëm pas lirimit nga burgu.

e) Veprimtaritë fetare

Shumë VEP kanë një pikëpamje fikse ose 'të përshtatshme' për fenë ose ideologjinë e tyre që lejon arsyetimin e përdorimit të ardhshëm të dhunës kundër një grupi ose feje tjetër. Prandaj, qëllimi i aktiviteteve fetare duhet të jetë edukimi i VEP-ve

MATERIALET E REFERENCËS

Dokumenti i diskutimit nga Tema 1 e GP-së së 1-rë më 15-16 tetor 2019 Hotel CenterVille, Podgoricë

Dokumenti i diskutimit nga Tema 1 e GP-së së 2-të më 11-12 shkurt 2020 Hotel CenterVille, Podgoricë

Dokumenti i diskutimit nga Tema 1 e GP-së së 3-të më 1-3 dhjetor 2020 në internet

Dokumenti i diskutimit nga Tema 2 e GP-së së 1-rë më 13-14 nëntor 2019 Hotel Novotel Bristol, Sarajevë

Dokumenti i diskutimit nga Tema 2 e GP-së së 2-të më 9-10 qershor 2020 përmes platformës Kudo në internet

Dokumenti i diskutimit nga Tema 2 e GP-së së 3-të më 13 dhe 14 tetor 2021 Hotel Ibis Styles, Sarajevë

Dokumenti i diskutimit nga Tema 3 e GP-së së 1-rë më 11-12 dhjetor 2019 Hotel Rogner, Tiranë

Dokumenti i diskutimit nga Tema 3 e GP-së së 2-të më 6-7 korrik 2020 përmes platformës KUDO në internet

Dokumenti i diskutimit nga Tema 3 e GP-së së 3-të më 17-18 nëntor 2021 Hotel MAK, Tiranë

Dokumenti i diskutimit nga Tema 4 e GP-së së 1-rë më 21-22 janar 2020 në Hotel Holiday Inn, Shkup

Dokumenti i diskutimit nga Tema 4 e GP-së së 2-të më 4-6 nëntor 2020 në internet

Dokumenti i diskutimit nga Tema 4 e GP-së së 3-të më 21-22 dhjetor 2021 Hotel Mariot, Shkup

Konkluzionet nga konferenca e fundit rajonale: "Drejt përmirësimit të praktikave në parandalimin e radikalizimit dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe trajnimin e stafit në Ballkanin Perëndimor", më 17–18 maj 2022 në H. Splendid, Budva, Mali i Zi. (Temat 1 dhe 3)

Konkluzionet nga konferenca e fundit rajonale: "Drejt menaxhimit të suksesshëm, rehabilitimit dhe ndihmës pas vuajtjes së dënimit për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (VEP) në Ballkanin Perëndimor – arritjet dhe rruga përpara", më 04–05 tetor 2022 në Hotel MAK, Tiranë. (Temat 2 dhe 4).

Raporti i vlerësimit për pilotimin e mjeteve/programit specifik për VEP në Serbi

Raporti i vlerësimit për pilotimin e mjeteve/programit specifik për VEP në Shqipëri

Raporti i vlerësimit për pilotimin e mjeteve/programit specifik për VEP në Kosovë

Raporti i vlerësimit për pilotimin e mjeteve/programit specifik për VEP në BeH

Raportet përfundimtare të vlerësimit për zbatimin e forumeve lokale të koordinimit në BeH, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Shqipëri (zbatuar nga qershori 2020 – qershor 2022)

Përgjigjet ndaj pyetësorëve të përshtatur të dorëzuar nga përfituesit

Ky dokument i politikës u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t' i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int